



30 Ditët
e lutjes
PËR BOTËN MYSLIMANE

Thirrje të krishterëve për t'u lutur
me besim, shpresë dhe dashuri,
që nga viti 1993

18 QERSHOR - 17 KORRIK 2015

Të dashur miq lutës,

Vitin e kaluar, menjëherë pasi udhëzuesi i lutjes 2014 u dërgua për shtyp, Roni, koordinatori ndërkombëtar për udhëzuesin “30 ditët e lutjes për botën myslimane”, shkoi të jetë me Zotin. Vdekja e Ronit ishte e papritur dhe një humbje e madhe për këtë lëvizje të lutjes. Ne dëshironim ta nderonim atë me këtë edicion për përkushtimin e tij në dashurinë ndaj myslimanëve nëpërmjet lutjes dhe informimit të Trupit të Krishtit për botën myslimane, dhe si të lutemi për të.

Përpara se të vdiste, Roni bëri rregullimet e nevojshme që edicioni 2015 të organizohet rreth një serie artikujsh prej David Garrison-it, një studiues dhe autor i librit *Një erë në Shtëpinë e Islamit*. Davidi e ka ndarë bujarisht përbajtjen e librit të tij frymëzues me lexuesit tanë për këtë edicion. Ne e dimë se ju do të jeni tepër të inkurajuar ndërsa do të lexoni për ndikimin global të mbi 20 viteve lutjeje të rregullt për botën myslimane, nxituri prej këtij udhëzuesi.

Ne duam t’i shprehim falënderimet tona pjesës tjetër të skuadrës së vullnetarëve të 30 Ditëve Ndërkombëtare për durimin dhe mbështetjen e tyre në përgatitjen e udhëzuesit të këtij viti, dhe i kërkojmë lexuesve tanë ta kujtojnë skuadrën në lutje.

Le të vazhdojmë të lutemi!

Botuesit, 30 Ditët Ndërkombëtare



Në këtë botim

Çfarë besojnë myslimanët e sotëm	2
Fokusi ynë	4
Harta e botës	5
Dhomat në Shtëpinë e Islamit	6
Ditët 1—30 fillojnë temat e lutjes	7
Të bërët paqe me myslimanët	20
Lutje përgjatë vitit	32



Çfarë besojnë myslimanët e sotëm

Shumica e myslimanëve besojnë me vendosmëri të "Pesë Shtyllat".



97%

Deklarojnë besimin tek Allahu dhe profeti Muhamed

93%

Agjërojnë gjatë Ramazanit

The Five Pillars: percentages practised

77%

Respektojnë Zekatin (dhëniet për bamirësi)

63%

Kryejnë Namazin (luten pesë herë në ditë)

9%

Pelegrinazhin në Mekë (Haxhi)

Përqindja e myslimanëve të cilët besojnë në secilën prej pesë shtyllave bazë të besimit, është si më poshtë:

Një Perëndi (Allahu):	97%
Dita e Gjykimit dhe besimi në parajsë :	94%
Dita e Gjykimit dhe besimi në ferr :	87%
Engjëjt:	88%
Kurani është fjala e saktë e Perëndisë:	80%
dhe në SHBA:	50%
Profeti Muhamed:	97%

Përqindja e myslimanëve të cilët besojnë në fat – "Nëse do Allahu" (fatalizmi/i quajtur "in sha Allah") – është:

Lindja e Mesme/Afrika e Veriut :	93%
Azia e Jugut:	91%
Azia Juglindore:	89%
Azia Qendrore:	88%
Evropa Juglindore :	57%

A është e mundur që të ketë më shumë sesa vetëm një interpretim të saktë të mësimëve të besimit?

Ja përqindjet e myslimanëve në shtete të ndryshme të cilët mendojnë se është e mundur:

Tunizia:	58%
ShBA:	57%
Libani:	45%
Jordani:	23%
Egjipti:	21%
Kirgistani dhe Malajzia:	17%

Sa e rëndësishme është feja në jetët e myslimanëve?

Në Amerikën e Veriut, më pak se 25% e myslimanëve thonë se feja është shumë e rëndësishme për jetët e tyre.

Në Afrikën e Saharasë së Poshtme, Afganistan dhe Indonezi, 50% ose më shumë e myslimanëve shkojnë në xhami disa herë në javë.

Në shumë shtete, recitimi i poezive në lavdërim të Allahut është i pranueshëm, edhe po jo në Pakistan apo në Indonezi.

Statistikat janë marrë nga: pewforum.org/2013, "Myslimanët e botës: feja, politika dhe shoqëria", një studim i bazuar mbi 38 000 intervista në mbi 80 gjuhë, në 39 shtete me një popullsi të konsiderueshme myslimane.

Shumë myslimanë raportojnë se kanë objekte në shtëpitë e tyre për të larguar syrin e keq. Ja disa nga vendet:

Turqia:	37%
Afganistani:	36%
Rusia:	35%
Egjipti:	29%
Indonezia:	4%

Kur flitet për çështjen sunite dhe shiite:

Mbi 50% e myslimanëve të Evropës dhe të Azisë Qendrore e identifikojnë veten si "thjesht myslimanë" në vend që të identifikohen si sunitë apo shiitë.

Disa përqindje të myslimanëve sunitë, të cilët thonë se shiitët NUK janë myslimanë, përfshijnë vendet:

Iraku:	14%
Libani:	21%
Tunizia:	41%
Maroku:	50%
Egjipti:	53%

Numra të tjerë kyç:

50% ose më shumë janë "të shqetësuar për grupet fetare ekstremiste në vendin e tyre".

Shumica dërrmuese e myslimanëve bien dakord se imoraliteti përfshin: prostitucionin, homoseksualitetin, vetëvrasjen, abortin, eutanazinë dhe konsumimin e alkoolit.

50% ose më shumë e konsiderojnë divorcin si një praktikë morale të pranueshme.

50% ose më shumë besojnë se një grua duhet t'i bindet gjithmonë bashkëshortit të saj.

50% ose më shumë besojnë se është detyra e tyre fetare që të përpiqen t'i kthejnë të tjerët në fenë islamike.

Për t'u theksuar:

Pothuajse gjysma e myslimanëve amerikanë thonë se të gjithë (7%) ose shumica (41%) e miqve të tyre të afërt janë myslimanë të tjerë; gjysma tjetër thotë se disa (36%) ose thuajse asnjë (14%) prej miqve të tyre të afërt janë myslimanë.

Çfarë mundësie e madhe për të krishterët amerikanë që t'i arrijnë fqinjët dhe kolegët myslimanë dhe të bëhen miq të afërt me ta!



30 ditët e lutjes për botën myslimane

Duke inkurajuar, duke edukuar dhe duke pajisur që prej vitit 1993

Edhe pse problemet e hasura prej botës myslimane ndryshojnë nga viti në vit, synimi i udhëzuesit “30 ditët e lutjes për botën myslimane” mbetet inkurajimi, edukimi dhe pajisja. Nëpërmjet lutjes, ne mund të angazhohemi në vepra dashurie për myslimanët në të gjithë botën – duke ndarë barrët e tyre, duke kuptuar shqetësimet e

tyre dhe duke iu përgjyruar Perëndisë që t’i ndihmojë ata. Në këtë mënyrë, ne përmbushim urdhrin e Jezusit që t’i duam të afërmit tanë.

Inkurajimi

30 Ditët Ndërkombëtare filloi me një grup njerëzish të cilët u ndjenë të shtyrë për të ndryshuar mënyrën si ata e kuptonin botën myslimane, dhe që t’i shihnin ata ashtu siç i sheh Perëndia – si individë, familje dhe fise unike. Lexuesit inkurajohen që të lutën për të njëjtin

frëmëzim dhe të lejojnë Perëndinë që t’i drejtojë lutjet e tyre me njohurinë e Tij të dashur për botën myslimane.

Edukimi

Me më shumë informacion në dispozicionin tonë se kurrë më parë, është e nevojshme që të përdorim dallimin në mënyrën se si e formojmë kuptimin tonë për botën rreth nesh. Ky udhëzues e mbledh informacionin e tij për botën myslimane prej njerëzve të cilët jetojnë midis myslimanëve, me qëllim që t’i duam ata dhe t’i bekojmë, dhe përpiqet që t’i japë jehonë zërave të tyre. 30 Ditët Ndërkombëtare beson se ne mund ta kuptojmë më mirë atë që myslimanët besojnë nga vetë myslimanët, dhe shpreson që t’i ndihmojë lexuesit tanë që të dallojnë larminë që ekziston në kultura dhe teologji brenda botës myslimane.

Pajisja

Lutja gjatë Ramazanit është një mënyrë e dobishme për të krishterët që të identifikohen me myslimanët. Gjatë

kësaj kohe, shumë myslimanë po kërkojnë takime me Perëndinë dhe një kuptim më të mirë të udhëve të Tij. Çdo vit, ne marrim raportime se kjo është ajo që Perëndia bën – edhe për myslimanët, por edhe për të krishterët të cilët lutën për ta. Kjo është një kohë e përsosur për t’u folur miqve tanë myslimanë për atë që Perëndia po ju zbulon, dhe për të ndarë me të krishterët të tjerë atë që po mësoni ndërsa po luteni.

Për informacione të mëtejshme për lëvizjen e 30 Ditëve dhe për ide se si të luteni në mënyrë më të efektshme, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: www.30-days.net



Nëpërmjet lutjes, ne angazhohemi në vepra dashurie për myslimanët rreth botës



Ku po na çojnë lutjet tona?

Numrat në këtë hartë tregojnë faqet se ku do të gjeni një artikull rreth lutjes për atë zonë të botës.

A E DINIT?

23.2% e popullsisë botërore identifikohen si myslimanë – që do të thotë 1.6 miliardë njerëz.

62% e këtyre popujve jetojnë në rajonin Azi-Paqësor;

20% në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut;

16% në Afrikën e Saharasë së Poshtme;

3% në Evropë.

Më pak se 1% e popullsisë globale myslimane jeton në Amerikën e Veriut, Amerikën Latine dhe në Karaibe.

(Qendra e Bankës Kërkimore, Dhjetor 2012)



Nëntë Dhomat në Shtëpinë e Islamit

Këtë vit, udhëzuesi i lutjes strukturohet rreth një libri të publikuar së fundi nga David Garrison, i titulluar "Një erë në Shtëpinë e Islamit." Libri eksploron nëntë zona gjeokulturore të identitetit mysliman – të përshkruara si "Dhomat në Shtëpinë e Islamit" – ku ka lëvizje njerëzish të cilët po kthehen në besimin të Jezusi. Nëntë Dhomat shpjegohen në faqet e këtij udhëzuesi, me mundësi të mëtejshme për lutje.



Një kthim i jashtëzakonshëm

“
po përjetojmë
kthimin më
të madh e më
të përhapur
në histori të
myslimanëve
te Krishti

Prej rreth 14 shekujsh, islami dhe krishterimi janë përfshirë në një garë shpirtërore për shpirtrat e qindra miliona burrave, grave dhe fëmijëve. Gjatë 12.5 shekujve të parë, islami ka qenë dukshëm fitimtar. Që kur profeti arab, Muhamedi, themeloi fenë e tij në vitin 622 pas Krishtit, dhjetëra miliona të krishterë janë degdisur në Shtëpinë e Islamit, sikurse e quajnë myslimanët perandorinë e tyre fetare botërore, me mbi 1.6 milionë anëtarë sot.

Po e kundërta? A ka pasur lëvizje myslimanësh, lëvizje me të paktën 1 000 besimtarë të pagëzuar, që janë kthyer nga islami në krishterim? Deri së fundmi, përgjigjja e habitshme ka qenë ‘jo’.

Gjatë 350 viteve të para të historisë së islamit, gjersa popullsitë që rrëfenin të ishin të krishtera nga Lindja e Mesme

deri në Spanjë pushtoheshin nga ushtritë islame dhe më vonë ktheheshin në besimin islamik, ka pasur vetëm një lëvizje në drejtimin tjetër. Në vitin 982, sipas historisë, 12 000 burra arabë (mendohet bashkë me familjet e tyre) kërkuan të pagëzohen dhe u kthyen në të krishterë.

Dy lëvizje të tjera ndodhën në shekujt XII dhe XIII, përkatësisht në Libanin dhe Libinë e sotme.

Gjashtë shekuj thatësisirë pasuan, pa as edhe një lëvizje të regjistruar myslimanësh drejt Krishtit.

Pastaj, në vitin 1870, në ishullin e largët të Javës (Indonezi), ndodhi lëvizja e parë e kohëve moderne e myslimanëve drejt Krishtit, e pasuar një dekadë më vonë nga një lëvizje e dytë në vitet 1890-1920 në Etiopi.

Shekulli XX nisi me shpërqendrimin global të dy luftërave botërore, dhe me depresionin e madh ekonomik mbarëbotëror. Duhej pritur të vinte viti 1967 për të parë një lëvizje tjetër, sërisht në Indonezi, këtë herë të më shumë se dy milionë myslimanëve, të cilët u pagëzuan në qindra kisha të krishtera.

Gjatë dy dekadave të fundit të

shekullit XX, rryma nisi të ndryshojë drejtim. Lëvizjet shpërthyen në Algjeri, Azinë Sovjetike Qendrore, Bangladeshin dhe Iran. Gjatë 14 viteve të para të shekullit XXI, lëvizje të reja myslimanësh drejt Krishtit kanë shpërthyer anembanë botës islame, nga Afrika Perëndimore deri në Azi, dhe gjithandej në këtë hapësirë. Vetëm shekulli XXI ka sjellë shtimin e 69 lëvizjeve të reja të myslimanëve drejt Krishtit. Në ditët tona po përjetojmë kthimin më të madh e më të përhapur në histori të myslimanëve te Krishti.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Nuk është rastësi që vala e tanishme e lëvizjeve të myslimanëve drejt Krishtit po ndodh në të njëjtën kohë me shtimin e lutjes për botën islame. Lëvizja “30 ditët e lutjes” sapo ka festuar 23-vjetorin. Lutuni që Fryma e Perëndisë të vazhdojë të lëvizë fuqimisht në botën myslimane, për të tërhequr miliona myslimanë drejt pëmbushjes së nevojës së tyre për shpëtim, vetëm në Krishtin!*



Afganistani – Nëse kërkon, do të gjesh!

Dishepullimi është sfidë e vështirë dhe e rrezikshme në një vend ku identifikimi si ndjekës i Jezusit mund të të bëjë shënjestër të dhunës ekstremiste. Megjithatë, një besimtar në Afganistan tregon këtë histori, sesi ata që kërkojnë me ngulm, po e gjejnë atë që po kërkojnë ...

“E takova njërin prej besimtarëve tanë të rinj në një medie sociale. U tregova i rezervuar për ta takuar ballë për ballë, por i dërgova padashur numrin tim të celularit. Nisi të më merrte në telefon vazhdimisht, ditë e natë, duke më kërkuar që të takoheshim dhe që t’i siguroja kopje të Dhiatës së Re.

Kësisoj, u luta për këtë dhe rashë dakord ta takoja. I thashë ‘mirupafshim’ familjes dhe putha fëmijët. Së bashku me një tjetër besimtar të ri shkova me makinë në pjesën e qytetit ku banonte ai dhe e parkova makinën larg nga vendi ku po më priste. I thashë shokut tim: ‘Nëse nuk të dërgoj mesazh për 10 minuta, largohu me makinë dhe bashkë me gjithë të tjerët largohuni menjëherë nga qyteti.’

Kur e takova këtë vëlla, ai më përqafoi fort dhe ishte shumë i lumtur

që po më takonte, por sinqerisht, kur po përpiqej të afrohej akoma, po mendoja sesi të largohesha! Megjithatë, ai më siguroi që nuk kishte asnjë problem, kështu që i dhashë dy kopje të Dhiatës së Re. Ishte shumë i entuziazmuar. Ai kishte gjetur atë që kishte dëshiruar prej shumë kohësh. Ditën tjetër u ritakuam dhe ai më tregoi historinë e tij...

Ai po kërkonte Jezusin dhe nuk mund të gjente askënd t’i fliste në qytetin ku banon. Kësisoj, ai vendosi të kursente ca para e të blinte një kompjuter të përdorur. Kishte marrë leje të përdorte një linjë interneti dhe kishte mësuar vetë sesi të përdorte postën elektronike dhe medien sociale. Kishte nisur të kërkonte besimtarë të tjerë në vendin tonë. Më gjeti, pavarësisht gjithë atyre sfidave! Tani është i gëzuar që mund të mësojë për Jezusin, ashtu sikurse edhe familja e tij. Ai po ua tregon atë që kupton vetë të tjerëve. Perëndia

e bën punën e Tij në mënyra që ne nganjëherë nuk i kuptojmë dot, por ne i japim lavdi!”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për ata që po përpiqen të kuptojnë më shumë për Jezusin në Afganistan, që dyert të hapen që ata të mund të gjejnë mësimet e Krishtit.*
- *Lutuni për paqe në këtë vend dhe për liri për të adhuruar e për të ndjekur Perëndinë.*
- *Lutuni për sigurinë dhe nxitjen e atyre që besojnë fshehurazi.*



DITA 3

E shtunë,
20 qershor

Nëntë Dhomat

Nëntë Dhomat e Shtëpisë së Islamit

Nëse do të lutemi në mënyrë të frytshme për botën myslimane, ne duhet ta shohim botën myslimane ashtu si e sheh ajo veten, siç është.

Abu Hanifa (699-767 pas Krishtit), jurist mysliman i shekullit VIII, e ndau botën në dy shtëpi: Shtëpia e Islamit (Dar al-Islam, në arabisht) dhe Shtëpia e

Luftës (Dar al-Harb). Shtëpia e Islamit përfshinte ato kombe ku myslimanët ishin popullata dominuese dhe ligji islamik udhëzonte drejt nënshtrimit islamik. Shtëpia e Luftës përbëhej nga vende ku myslimanët ishin pakicë dhe islami nuk ishte akoma mbizotërues.

Shtëpia e Islamit, me 1.6 miliardë anëtarë, është larg të qenët e njëtrajtshme. E shtrirë me mijëra milje nga

Afrika Perëndimore deri në Indonezi, Shtëpia e Islamit është po aq e

larmishme sa feja e krishterë.

Myslimanët në Afrikën Perëndimore ndryshojnë nga ana kulturore, gjuhësore dhe pikëpamjet për botën

nga ata të Iranit, Bangladeshit ose Indonezisë. Për t'u lutur me më shumë urtësi për botën islame, ne duhet ta shohim atë në gjithë këtë shumëllojshmëri kulturore.


Shtëpia e Islamit mund të ndahet nga ana gjeokulturore në nëntë rajone të dallueshme ose në Dhomat e Shtëpisë së Islamit. Këto Nëntë Dhoma janë: (1) Afrika Perëndimore, (2) Afrika Veriore, (3) Afrika Lindore, (4) Bota Arabe, (5) Bota Perse, (6) Turkistani, (7) Pjesa Perëndimore e Azisë Jugore, (8) Pjesa Lindore e Azisë Jugore dhe (9) Indo-Malajzia.

Afrika Perëndimore dhe Afrika Lindore janë plot me myslimanë me prejardhje animiste fisnore, të cilët janë shfrytëzuar historikisht nga pushtues myslimanë dhe evropianë nga veriu. Bota islame, prej së cilës i ka fillesat edhe islami, ka qenë më parë atdheu i krishterë që nxori shumë prej etërve më të hershëm dhe më të famshëm të Kishës. Bota perse ka qenë kryesisht zoroastriane, por me komunitete të forta të krishtera dhe judaike, para se të pushtohesh nga ushtritë islame të shekullit VII. Turkistani i Azisë Qendore

ishite shtëpia e fiseve shamaniste turko-mongole, si kanët mongolë dhe timurlengët, me komunitete të shpërndara të të krishterëve nestorianë, para se Timurlengu dhe Hordhitë e Arta t'i fshinin nga faqja e dheut në shekujt XIV-XVI. Po këta pushtues turkistanezë nënshtruan popujt e Azisë Perëndimore ku tani ndodhen Afganistani, Pakistani dhe India Perëndimore në shekujt që pasuan përparimin islam në lindje, drejt mbretërive të përmbysura hindu dhe budiste të territoreve ku sot ndodhen India Lindore, Bangladeshi dhe Birmania perëndimore. Në shekullin XIII, islami kishte shkelur në arkipelagun indonezian, duke kthyer pak nga pak hindu-spiritualizmin e Malajzisë së sotme dhe të vendit më të madh mysliman në botë, Indonezisë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për secilën prej Nëntë Dhomave të Shtëpisë së Islamit me emër. Kërkojini Perëndisë të derdhë Frymën e Tij te myslimanët e këtyre Dhomave, duke i ndërgjegjësuar për nevojën e tyre për shpëtim përmes personit të Jezu Krishtit.*



Një erë në Shtëpinë e Islamit nga David Garrison

DITA 4

E diel,
21 qershor

Pjesa Lindore
e Azisë Jugore

Universiteti i Dakës, Bangladesh

Universiteti i Dakës (UD) është universiteti më i vjetër dhe më i madh në Bangladesh. Universiteti, i themeluar në vitin 1921, mbahej si “Oksfordi i Lindjes” gjatë viteve të para të tij. Në të gjenden një gamë e gjerë institutesh dhe departamentesh të disiplinave të ndryshme me mëse 38

000 studentë dhe 3 000 pjesëtarë stafi. Motoja e universitetit është: “E vërteta do të mbizotërojë!”.

Një profesor i moshuar i shoqëron plot gëzim vizitorët drejt shkallëve të përparme të universitetit, ku një monument me dy burra dhe një grua gjatë një akti heroik i kujtojnë vizitorit se Universiteti i Dakës ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë moderne të Bangladeshit. Pas ndarjes së Indisë, ai u bë qendra e lëvizjeve përparimtare dhe demokratike. “Ne do ta vazhdojmë këtë traditë,” – siguron profesori.

Vitet e fundit u themelua një departament i vogël i quajtur Departamenti i Feve dhe Kulturës Botërore.

“Ata mund të japin mësim tërë ungjillin e të tregojnë histori për Jezu Krishtin.”

Lektorët nuk janë mësuesit e vetëm të këtyre orëve mësimore; janë të ftuar edhe besimtarë të këtyre feve për të dhënë mësim. Kjo u jep rast të krishterëve, një pakicë prej 0.5%, për t’u dëgjuar në shoqërinë e Bangladeshit. Ata mund të japin mësim tërë ungjillin e të tregojnë histori për Jezu Krishtin. Çdo vit, rreth 300 studentë kanë rastin të lexojnë pjesë të Biblës dhe të mësojnë rreth Lajmit të Mirë. Departamenti mbështet dialogun, por jo sinkretizmin (përzierjen). Ata thonë: “Ne duhet ta njohim mirë besimin e gjithsecilit, në mënyrë që të mund të respektojmë atë që beson tjetri!”

SI MUND TË LUTEMI?

- Që Departamenti i Feve dhe Kulturës Botërore të vazhdojë me këtë vijë mendjehapur veprimi.
- Që zemrat dhe mendjet e studentëve të jenë të hapura dhe motoja e universitetit të bëhet realitet: “E vërteta do të mbizotërojë!”
- Që Perëndia t’i drejtojë lektorët dhe profesorët e krishterë ndërsa japin mësim.

DITA 5

E hënë,
22 qershor

Afrika
Perëndimore

Afrika Perëndimore: Tregim për dy oqeane

Ari i Afrikës Perëndimore, fildishi dhe skllëvërit i kanë tërhequr pushtuesit e huaj që kur historia ka nisur të regjistrohet. Afrika Perëndimore është tregim për dy oqeane: Atlantiku në perëndim dhe Shkretëtira e Saharasë në veri. Këto oqeane i veguan, por ishin edhe rrugë hyrëse për tek mëse 300 milionë banorët e rajonit. Nëpërmjet Atlantikut nisën të vinin evropianët në shekullin XV për të vendosur tregjet prej të cilave do të mblidhnin skllëvër dhe ar, e më

pas duke formuar koloni nga Mauritania e sotme në veri, deri në Nigeri në jug. Oqeani tjetër, Shkretëtira e Saharasë, të cilën shpesh nuk arrijmë ta shohim,

kishte siguruar tashmë një udhë për pushtuesit veriorë shekuj më parë. Saharaja, për shumë kohë pengesë e

padepërtueshme, u kishte dhënë mundësi kalimi pushtuesve arabë dhe berberë nga Afrika Veriore me karvanë devesh, të quajtur me të drejtë “anijet e shkretëtirës”, që në shekullin VIII, e që kërkonin të njëjtat çmime – skllëvër, fildish dhe ar – e linin në këmbim besimin e tyre islamik.

Në vitet 60, lëvizjet për pavarësi përfshinë Afrikën Perëndimore, por konflikti i vjetër mes komuniteteve të krishtera dhe atyre myslimane u përshkallëzua. Sot Afrika Perëndimore është e ndarë mes popullatave myslimane në veri e lindje, përgjatë Sahelit (fjala arabe për “breg”), dhe popullatave të krishtera në zonat jugore dhe perëndimore në bregdetin e Atlantikut.

Tërheqja e mëparshme nga skllëvërit, fildishi dhe ari është zëvendësuar me tërheqje të tjera si diamantet, që çuan në luftërat me gjenocid në Sierra Leone dhe Liberi (1980-2002), dhe zonat e pasura naftëmbajtëse që kanë prodhuar edhe pasuri, edhe konflikt në vendin më të populluar afrikan, Nigeri.

Krishterimi është rritur shpejt në Afrikën Perëndimore gjatë shekullit të

kaluar dhe një pjesë e madhe e pasurisë ka qenë nën kontrollin e komuniteteve të krishtera që jetonin afër brigjeve atlantike të rajonit.

Myslimanët në pjesën e thellë e të thatë kanë përjetuar pakësim të pasurive e tyre ndërsa ngrohja globale dhe zmadhimi i Saharasë ka zvogëluar tokat bujqësore dhe kullotat. Rezultati është një popullatë gjithnjë e më e varfër dhe e dëshpëruar islamike, çka ka sjellë reagime agresive nga grupe si Boko Haram në Nigeri, Ansaru dhe Lëvizja për Unitet dhe Xhihad në Afrikën Perëndimore.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për ato dhjetëra lëvizje të myslimanëve drejt Krishtit që kanë lindur në Afrikën Perëndimore.*
- *Lutuni për nevojat fizike dhe shpirtërore të popullsisë myslimane në Afrikën Perëndimore.*
- *Lutuni që Perëndia t’i mbrojë myslimanët e kthyer te Krishti nga sulmet e grupeve militante islamike si: Boko Haram në Nigeri, Ansaru dhe Lëvizja për Unitet dhe Xhihad në Afrikën Perëndimore.*

WEST AFRICA

Kombe	22
Grupe etnike myslimane	514
Popullsia gjithsej	335,556,076
Popullsia myslimane	105,239,092



Populli i Malit të veriut

Veriu i Malit është një ranishte e stërmadhe, pjesë e Saharasë jugore.

Kjo zonë njihet për tuaregët me veshjet e tyre karakteristike blu, hipur mbi devetë e tyre.

Më pak të njohur janë Songhaitët të cilët jetojnë përgjatë lumit Niger në verilindje të Malit, kryesisht në qytetet Gao dhe Timbuktu. Që nga mesi i shekujve XV dhe XVI, perandoria e Songhait ishte një nga perandoritë më të mëdha islamike të historisë. Kjo zonë është ende e paungjillëzuar në pjesën më të madhe të saj — 99% janë myslimanë dhe ka shumë pak të krishterë.

Tamashekshja dhe songhaishtja janë dy gjuhët kryesore të cilat fliten

në Malin e veriut. Dhiata e Re ka disa vite që është e disponueshme në gjuhën tamashekshe, ndërsa versioni songhaisht sapo iu shpërnda dhe dedikua kësaj popullsie në janar të vitit 2015. Fjala e Perëndisë në këto gjuhë, është çelësi për tek zemra e njerëzve.

Konflikti i vazhdueshëm dhe shtimi i ekstremizmit si rezultat i kryengritjeve të vitit 2012 dhe 2013, ka bërë që një pjesë e mirë e popullsisë të zhgënjehet nga islami. Kjo ka krijuar një hapje të madhe ndaj besimit të Jezusi, por ka shumë pak punonjës që adresojnë nevojat e jashtëzakonshme fizike dhe shpirtërore të këtij rajoni.

Fatma është uloke nga njëra këmbë për shkak të poliomielitit. Përgjatë viteve, ajo ka shfaqur interes për të ditur

më shumë rreth Jezusit dhe madje ka dhënë ndihmesën e saj në përkthimin e Biblës. Megjithatë, ajo nuk merr guximin që ta rrëfejë haptas besimin e saj tek Jezusi për shkak se ka frikë se mos e përzënë nga familja e vet. Kjo gjë vlen të thuhet edhe për shumë të tjerë në Malin e veriut.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për paqe në konfliktet e ndezura të këtij rajoni.*
- *Lutuni për mundësi që më shumë njerëz në Malin e veriut të kuptojnë mesazhin e Krishtit, si dhe fuqinë e tij për të transformuar dhe sjellë paqe.*
- *Lutuni për më shumë punëtorë të krishterë, të cilët mund të tregojnë dashurinë e Jezusit në këtë zonë.*



Afrika e veriut: besimi i etërve tanë

Për shekuj me radhë, Afrika e Veriut qe një bastion i krishterë prej nga ku dolën disa prej drejtuesve më të mëdhenj të krishterimit. Agustini, Tertuliani, Cipriani, Perpetua dhe Felicitasi kanë frymëzuar dhe nxitur breza të tërë të krishterësh deri në ditët e sotme.

Pavarësisht kësaj trashëgimie të shkëlqyer shpirtërore, mbërritja e islamit në shekullin e shtatë, shënoi fillimin e fundit të një prej fortesave më të mëdha të krishterimit.

Aty rreth shekullit XII, me pushtimin nga fiset beduine arabe, krishterimi indigjen pothuajse u zhduk.

Sot, vendet e Afrikës së Veriut me një shtrirje nga Mauritania deri në Libi,

pretendojnë të jenë 99 përqind islamike: por diçka është duke ndryshuar.

Afrika e Veriut është historikisht vendi i berberasve. Ky është një popull autokton malësorësh, të cilët përgjatë shekujsh kanë parë pushtues të vijnë e të shkojnë në trevën e tyre. Një pjesë e mirë e kësaj popullsie sot, është një përzierje e kulturës berbere me atë arabe e cila ka qenë në krye të konfliktit shekullor mes Shtëpisë së Islamit dhe Perëndimit.

Refiku ishte një nga miliona berberasit që u largua nga atdheu i tij në Afrikën Veriore, në kërkim të një jete më të mirë në Evropë. Ai e konsideronte veten më shumë si evropian sesa si mysliman. Ai ishte një muzikant dhe kompozitor i talentuar. Rafiku, për arsye që as vetë nuk i dinte, zgjodhi jetën e Jezusit si subjekt të një komedie muzikore që ai po shkruante. Duke u kredhur në studimin e ungjijve, Refiku u bë një pasues i Jezusit.

Kur u kthye në Afrikën e Veriut me besimin e vet të ri, Refiku e gjeti veten në mes të një grumbulli prej mijëra vetësh nga bashkatdhetarët e tij, të cilët kishin zbuluar gjithashtu se çfarë kishte

shkruar paraardhësi i tyre, Agustini, rreth 15 shekuj më përpara: “Shpirti nuk gjen dot prehje, derisa ta gjejë prehjen tek Ti.” Ky ndjekës i Krishtit me prejardhje myslimane, tha: “Paraardhësit tanë ishin pasues të Jezusit. Agustini ishte një berberas si ne. Ne jemi thjesht duke u kthyer në besimin e etërve tanë.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për lëvizjet në ngritje e sipër në Afrikën e Veriut.*
- *Lutuni për televizionet satelitore dhe shërbesat radiofonike të cilat kanë kontribuar ndaj këtyre lëvizjeve.*
- *Lutuni për familjet e krishtera në Afrikën e Veriut, të cilat kërkojnë t'i rrisin si besimtarë fëmijët e tyre, paçka se përballë një kundërshtie të fortë.*



vendet e Afrikës së Veriut me një shtrirje nga Mauritania deri në Libi, pretendojnë të jenë 99 përqind islamike: por diçka është duke ndryshuar.



AFRIKA E VERIUT

Kombe	6
Grupe etnike myslimane	82
Popullsia gjithsej	100,631,350
Popullsia myslimane	99,029,643

Çad: mundësi në zemër të Afrikës

Musai jeton në familjen e prindërve të tij në një fshat të vogël të Çadit.

Ai është në klasë të parë. Në klasë ai ka 210 nxënës të tjerë dhe një mësues. Shumicën e rasteve ai ulet përdhe, sepse nuk ka banka të mjaftueshme për të gjithë.

Fatkeqësisht, mësuesi i Musait i flet në frëngjisht, gjuhë të cilën ai nuk e kupton edhe aq mirë. Gjuha e tij është arabishtja çadiane.

Shumë herë, Musai dhe shokët e tij shkojnë më kot në shkollë, sepse mësuesi i tyre nuk vjen. Kur mësuesi është atje ama, ata e kalojnë pjesën më të madhe të kohës duke përsëritur atë që mësuesi thotë. Edhe pse Musai është i zoti në mësimin përmendsh të mësimëve të tij, ai nuk është se gjithnjë e kupton atë që është duke përsëritur. A do ta lërë ai shkollën fillore si pjesa më e madhe e fëmijëve nga Çadi, pa arritur të mësojë se si të lexojë apo shkruajë?

Kushëriri i Musait, Abdullahi, jeton në një fshat tjetër. Babai i Abdullahit është imami i fshatit të tyre. Fëmijët e tij të shumtë si dhe shkollimi i tyre, janë të rëndësishme për të, por shkollat publike

në atë zonë, nuk kanë arritur që të plotësojnë standardet që ai dëshiron për fëmijët e vet. Kështu, ai i kërkoi një punonjësi të krishterë që të vinte e të hapte një shkollë për fëmijët e tij. Abdullahi e ka shumë qejf shkollën e tij. Ai është një student ndër 20 (motrat dhe vëllezërit e tij si dhe ca fëmijë të lagjes, të cilët mund ta përballojnë tarifën e shkollës private). Mësuesi i tij është i aftë të japë mësim edhe në frëngjisht, edhe në arabishten çadiane. Atij i pëlqen gjithashtu të dëgjojë historitë e Biblës që mësuesi u tregon çdo mëngjes. Kjo është shumë ndryshe nga mësimi përmendsh, por pa kuptuar gjël!

Situata katastrofike e sistemit publik të arsimit në Çad, ka bërë që myslimanët në të tërë vendin të kërkojnë për shkolla të krishtera për fëmijët e tyre, duke mirëpritur një arsimim të mirë për fëmijët e tyre si pjesë e bekimeve të mbretërisë së Perëndisë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Për më shumë mundësi të mira arsimore për fëmijët e Çadit.*

- *Që mësuesit të kenë mençuri dhe kurajë ndërkohë që japin mësim dhe demonstrojnë mesazhin e Krishtit.*
- *Që fara e Fjalës së Perëndisë do të rritet dhe japë fryte, dhe se shumë familje do të vijnë të ndjekin Jezusin.*



Afrika Lindore: një thirrje “maqedonase”

Ashtu sikurse Afrika Perëndimore, 357 milionë banorët e Afrikës Lindore janë shfrytëzuar si nga pushtuesit myslimanë, ashtu edhe nga ata të krishterë. Grupe të krishtera dhe myslimane janë ngatërruar brez pas brezi në konflikt me njëri-tjetrin.

Islami mbërriti për herë të parë në Afrikën Lindore në vitin 614 pas Krishtit, kur një grup refugjatësh myslimanë të dërguar nga profeti Muhamed, kërkuan azil për t'i shpëtuar përndjekjes nga fisi i tyre Kuraish. Kjo bazë islamike u zgjerua në shekujt pasues derisa islami u bë feja mbizotëruese e rajonit për mijëvjeçarim në vazhdim. Por, gjërat po ndryshojnë.

Eliasi ishte një misionar nga Afrika Lindore që jetonte në kampet e mbipopulluara somaleze të refugjatëve, në një qytet të madh në Bririn e Afrikës. Një mbrëmje ai u habit nga mbërritja e papritur e një sheiku somalez të quajtur Abdul-Ahad. Eliasi mendoi se mos kjo do të ishte ajo natë në të cilën grupi militant Al-Shabaab do të zgjidhte të merrte hak mbi edhe një tjetër të krishterë.

AFRIKA LINDORE	
Kombe	19
Grupe etnike myslimane	298
Popullsia gjithsej	357,412,280
Popullsia Myslimane	78,359,098

Sapo Eliasi hapi derën, sheiku aty për aty kërkoi të dinte: “M’u përgjigj, po apo jo. Gjaku i Jezusit pagoi për mëkatet e të gjithëve?”

Eliasi i tensionuar iu përgjigj, “Po.”

Sheiku iu përgjigj prerazi:

“Ti po gënjen!” Pastaj ngurroi për pak përpara se të thoshte: “Gjaku i Jezusit nuk mund të falë mëkatet e mia.”

Abdul-Ahadi i tregoi Eliasit për dhunën që kishte kryer në Mogadishun e rrënuar nga lufta. Pastaj, sheiku i moshuar filloi të dridhej e të qante. “Kam nevojë të çlirohem nga kjo,” tha ai.

Eliasi i tha atij: “Po që se unë e ti biem dakord sonte, atëherë Perëndia ka për të të falur.”


Sheiku i moshuar u lut me Eliasit dhe Abdul-Ahadi u shpëtua atë mbrëmje.

Përpara se të largohej, ai u kthye nga Eliasi dhe i tha: “Kur ti më shikon në rrugë, ti vëren çallmën myslimane dhe mjekrën time, dhe kjo të frikëson, por duhet të dish që përbrenda ne jemi bosh. Mos ki frikë prej nesh. Ne kemi nevojë për ungjillin.”

“Kjo ishte thirrja ime “maqedonase”, - tha Elija. - “Nuk më shqitet kurrë nga mendja.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që më shumë prej atyre miliona të krishterëve në Afrikën Lindore, do të përqafojnë thirrjen maqedonase për fqinjët e tyre myslimanë.*
- *Lutuni për myslimanët në Somalinë e copëtuar nga lufta si dhe për vendet fqinje me të, që të gjejnë paqe dhe liri në ungjillin e Jezu Krishtit.*
- *Lutuni që Perëndia të mbrojë lëvizjet në ngritje e sipër të myslimanëve për tek Krishti në Dhomën Afrikano-Lindore të Shtëpisë së Islamit.*



“Grupe të krishtera dhe myslimane janë ngatërruar brez pas brezi në konflikt me njëri-tjetrin.”

Orma dhe Vardei i Afrikës Lindore

Një punonjës atje shkruan: “Kur dielli perëndon, shikoj ormatët tek kthejnë kafshët në fshatin e tyre. Së pari, kalojnë djelmoshat me dhitë dhe delet, pastaj vijnë burrat me lopët. Kur arrijnë në fshat, zërat e kafshëve përzihen me zërat e këngëve të fëmijëve si dhe me buçitjen e daulleve. Fshati është në hare kur kafshët kthehen. Bariu e njeh çdo kafshë të vetën, dhe ato e njohin bariun e tyre. Kafshët e dinë rrugën, por nganjëherë ndonjëra prej tyre humbet dhe bariu kthehet në shkorret, duke thërritur: ‘Oa! Oa! Oa!’ derisa e gjen. Nëse nuk e gjen, të nesërmen marrin pjesë në kërkim edhe pjesëtarë të tjerë të familjes së tij.”

Vardeisat kanë një mënyrë të ngjashme jetese me atë të ormasëve. Ata jetojnë në rajonin e Delta Tanës në Kenia. Popullsia e tyre vlerësohet të jetë diku tek 53 000. Për ta ka pak informacion, dhe fare pak agjenci janë duke i ungjillëzuar specifikisht ato. Ata janë të izoluar nga grupet e tjera të njerëzve, paçka se disa prej tyre janë martuar me ormasët. Ata që vijnë nga fiset e tjera tek fshati i tyre,

zakonisht vijnë për të punuar për ta. Gratë vardeise, zakonisht merren me ndërtimin e shtëpisë së tyre, si dhe mbledhin dru zjarri. Ato gjithashtu merren me gatimin, shitjen e qumështit, shkojnë të marrin ujë dhe përkujdesen për viçat e vegjël. Burrat kujdesen për bagëtinë dhe shtegtojnë me to në kërkim të kullotave. Ata ndjekin islamin e disa martohen me më shumë se një grua, veçanërisht ata që kanë një pozitë drejtuese në fshat.

Përtypja e *mirajës (khatit)* është e zakonshme ndër burrat e Vardeit. *Miraja* është një bimë që rritet në këtë krahinë, e cila ka efektin e një droge. Me të bëhet mjaft tregti dhe ata e eksportojnë në Evropë.

Tradita thotë se vardeisat e kanë zanafillën e tyre nga ormatët dhe se ata qenë marrë robër nga somalezët për katër brezni.

Ata u kthyen në Kenia kur fituan pavarësinë. Kjo mund të jetë shpjegimi i arsyes përse ata flasin somalisht dhe jo ormalisht. Këto fise kanë të njëjtën histori. Le të lutemi që ata të gjejnë një të ardhme e cila të përfshijë Bariun e Mirë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që fiset në fjalë të gjejnë Bariun e vërtetë.*
- *Lutuni që ata të cilët kanë krijuar varësi nga miraja, të çlirohen nga ajo varësi si dhe nga tregtia e drogës.*
- *Lutuni që besimtarë të tjerë të çojnë tek fiset Orma dhe Vardei lajmet për Shpëtimtarin i Cili e jep jetën e Vet për delet e Tij.*


“
Jeta në
fiset Orma
dhe Vardei
të kujton
Gjonin
10:14-16,
ku Jezusi e
quan veten
Bariu i Mirë.”



Bota arabe: E di ku po shkoj

Bota arabe është dhoma qendrore në Shtëpinë e Islamit. Është një amalgamë racash dhe kombësisht që mbartin testamentin e pasardhjes së pushtuesve myslimanë arabë të shekullit të shtatë. Sot, Lidhja Arabe shtrihet në 22 kombe anëtare, dhe folësit e saj përbëjnë grupin e katërt ose të pestë gjuhësor më të madh në botë. Televizioni satelitor ose programet e radios dhe dëshmitë, si të misionarëve ashtu edhe të krishterëve të hershëm, po bëjnë të mundur që shumë myslimanë arabë të dëgjojnë mesazhin e ungjillit, por Fryma e Shenjtë po u tregon udhën myslimanëve arabë duke i bindur për nevojën që kanë për një Shpëtimtar. Një i tillë është një biznesmen 58-vjeçar, në pension, me emrin Mahad.

DHOMA QENDRORE SHTËPIA E ISLAMIT



BOTA ARABE

Kombe	21
Grupe etnike myslimane	240
Popullsia gjithsej	236,992,225
Popullsia myslimane	204,473,439

me kalimin e kohës në nevojën për një operacion në zemër.

“Doktorët më thanë se mundësitë e mia për mbijetesë nuk ishin më shumë se 5%. Ndërsa po më vinin në anestezi, u luta por nuk po ndieja paqe. Ndërsa po humbisja ndjenjat, thirra tri herë me zë, ‘Jezus!’”.



Nuk kam për ta harruar kurrë atë vizion..., por që prej asaj dite zemra ime është lidhur me atë të Jezusit.



“Menjëherë ndjeva paqe. Ndërsa isha në anestezi, pata një vizion të Jezusit dhe gruas sime; të dy së bashku në një livadh të bukur. Të dy dukeshin të lumtur. Ndjeva kaq gëzim. E dija se në botën e vërtetë unë duhet të kisha vdekur, por nuk e kisha problem; do të isha me ta. U afrova më shumë, por fillova të rrëzohesha, veçse nuk doja të kthehesha pas.

Nuk kam për ta harruar kurrë atë vizion. Operacioni ishte i suksesshëm,

por që prej asaj dite zemra ime është lidhur me atë të Jezusit. Përpara operacionit, kisha frikë nga vdekja, por tani e di se do të jem me gruan time dhe Jezusin. Gruaja ime gjithmonë e donte Jezusin. Ajo nuk më kishte thënë asnjëherë gjë për këtë, por ajo gjithmonë donte që Ai t’i ishte pranë.”

Ai mbante një skulpturë-reliev të vogël prej allçie të Darkës së Fundit të Da Vinçit, nga ato që u shiten turistëve në treg. “Ajo e bleu këtë shumë vite më parë. Kur të shkojmë në qiell, do ta pyesim për këtë.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që banorët e tokës së Biblës të rikthehen te besimi i Biblës.*
- *Lutuni që Perëndia t’i mbrojë besimtarët e rinj me prejardhje myslimane arabe, prej persekutimit që ata hasin për shkak se ndjekin Krishtin.*
- *Lutuni për milionia myslimanë arabë të cilët ende nuk e kanë dëgjuar lajmin e mirë të Jezu Krishtit.*

Egjipti: flet drejtuesi i një rrjeti kishash të fshehura

Në janarin e vitit 2014, Egjipti hodhi në draft një kushtetutë të re. Neni 1 e shpalli Egjiptin një shtet islamik; neni 2 e themeloi islamin si fenë zyrtare dhe *sharian* (ligjin islamik) si “burimin e legjislacionit” për vendin.

Edhe pse kushtetuta mbron të drejtat e minoriteteve fetare (të krishterëve, judenjve) më shumë se kushtetutat e mëparshme në Egjipt, nuk ka liri të plotë besimi. Ende konsiderohet e paligjshme që të kthehesh në një besim tjetër.

Bolos-i po drejton një organizatë të fshehtë të krishterë në vendin e tij, Egjiptin:

“Të krishterët në Egjipt, nga njëra anë, janë plot me gëzim dhe ndiejnë një dashuri të thellë për njerëzit e tjerë; nga ana tjetër, ata kanë frikë për jetët e tyre, sepse janë larguar nga islami dhe konsiderohen si femohues. Por, ata janë një dëshmi për Jezusin nëpërmjet dashurisë që tregojnë për të afërmit dhe për të njohurit e tyre. Kjo dashuri tashmë ka bërë që familje të tëra të besojnë te Perëndia i gjallë.

... Është një shërbesë e rrezikshme për shkak se ne nuk e kemi lirinë e besimit që kombet e tjera shijojnë. Ne

po punojmë fshehurazi për shkak se në Egjipt është e rrezikshme t’u flasësh myslimanëve për Jezusin. Nuk ka rrezik vetëm nga qeveria, por është gjithashtu e papranueshme për shoqërinë egjiptiane.

Egjiptianët të cilët kanë gjetur besimin te Jezusi janë të zellshëm që t’ua përcjellin egjiptianëve të tjerë dashurinë që kanë gjetur. Ne i mbështesim ata nëpërmjet trajnimeve dhe punës në rrjet. Ose i ndihmojmë ata që të themelojnë një biznes të vogël personal, si për shembull shërbim taksie, në mënyrë që të jenë financiarisht të pavarur nëse u duhet të largohen prej komuniteteve të tyre myslimane.

Ne, gjithashtu punojmë në shërbimet mjekësore, duke u ofruar të varfërve kontrolle falas dhe medikamente që nevojiten urgjentisht. Ne përpiqemi të jemi sa më të mençur. Fokusi ynë është gjithmonë mbi miqësinë, jo mbi diskutimet apo argumentet. Fqinjët tanë myslimanë e shohin mënyrën si ne

veprojmë. Ata fillojnë të bëjnë pyetje dhe ne u tregojmë atyre për dashurinë e Perëndisë.

Dua me gjithë zemrën time që mijëra, madje miliona myslimanë egjiptianë të gjejnë besimin e gjallë te Jezusi dhe të bëhen dëshmitarë të besimit të tyre kudo që jetojnë. Mbretëria e Perëndisë po ndërtohet këtu në Egjipt.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Që edhe familjet e besimtarëve të rinj egjiptianë të njohin Krishtin.*
- *Që më shumë kisha-shtëpi të fillojnë nëpër familjet myslimane të cilat kanë vendosur të besojnë te Jezusi.*
- *Që Perëndia t’u japë zemër besimtarëve egjiptianë që të qëndrojnë të fortë dhe t’u japë atyre fjalë dhe urtësi për të arritur fqinjët e tyre.*



Bota persiane: si e shoh Atë

Që prej ngritjes së Republikës Islamike të Ajatollahut në vitin 1979, pothuajse 100 milionë myslimanë shiitë të Iranit janë identifikuar për Perëndimin si anëtarë të “aksit të ligësisë” në botën tonë. Por një histori tjetër po shpaloset në Dhomën Persiane, në Shtëpinë e Islamit, një histori shpengimi dhe rilindjeje.

Që prej ngritjes në pushtet të Ajatollahut, qindra mijëra refugjatë iranianë janë larguar për në vende të tjera rreth botës. Kudo ku ata kanë shkuar janë themeluar kisha-shtëpi të reja nga ndjekësit e Jezu Krishtit me prejardhje myslimane iraniane. Gjatë dy dekadat e kaluara, Perëndia e përdori atë që njeriu e synonte për të keqen, që të sillte të mirën e tij. Kolapsi ekonomik, shpërthimi i varësisë ndaj drogës, luftëra shkatërrimtare me Irakun dhe

Perëndimin, të bashkuara me dëshmi të guximshme të besimtarëve, kanë bërë që mijëra iranianë të tërhiqen në besimin te Jezu Krishti.

Nadia dhe familja e saj u larguan prej Iranit dy vite

më parë dhe u mirëpritën ngrohtësisht prej komunitetit të krishterë në shtetin e tyre. Ajo dhe bashkëshorti i saj morën pjesë në një fundjavë për martesat e krishtera, për emigrantët me prejardhje iraniane, i projektuar për t’i ndihmuar çiftet me prejardhje myslimane që të rithemelojnë martesat e tyre mbi parime të krishtera, dhe të nxiten për të pasur një të kuptuar të krishterë për dashurinë midis një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje.

Njëri prej ushtrimeve shembuj ishte që një bashkëshort t’i shprehte dashurinë gruas së tij. Bashkëshorti i Nadias doli vullnetar. Ai e mori Nadian prej dore, dhe përballë të gjithë grupit i tha asaj me guxim: “Nadia, të dua!” dhe më pas e puthi publikisht.

Nadia e rikujton ngjarjen dhe skuqet: “Ajo ishte hera e parë në martesën tonë që bashkëshorti im më tha se më donte.”

Menjëherë pas kësaj, bashkëshorti i Nadias vdiq në mënyrë të papritur. Kur u pyet se si mundi ta duronte këtë dhimbje dhe humbje, ajo u përgjigj: “Ishte premtimi i Jezusit,” tha ajo, “ejani tek Unë, të gjithë ju që jeni të lodhur dhe të munduar, dhe Unë do t’ju jap

prehje. Jezusi më ka mbajtur. Jezusi më ka dhënë një paqe të mbinatyrshme.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që drejtuesit e Iranit të mos i drejtojnë miliona njerëz të vendit të tyre në shkatërrim të mëtejshëm.*
- *Lutuni që mijëra persianë, të cilët po vijnë në besim, të thellohen dhe të rriten në Krishtin.*
- *Lutuni që të krishterët në Perëndim ta zëvendësojnë urrejtjen dhe frikën e Iranit me dashuri dhe dhembshuri.*



BOTA PERSIANE


Kombet	3
Grupe etnike myslimane	105
Popullsia gjithsej	99,009,985
Popullsia myslimane	97,957,533

“
Jezusi më ka mbajtur.
Jezusi më ka dhënë një
paqe të mbinatyrshme.”

Paqebërje me Myslimanët?

Të ndjekurit e Princit të Paqes e kërkon këtë gjë!

Rick Love, PhD



Qershorin e kaluar dhashë mësim në një kurs mbi “Paqebërjen si misioni i Perëndisë” në Seminarin e Denverit. Gjoni, njëri prej studentëve prej Kenias, tregoi historinë rrëqethëse të grupit terrorist Al-Shabaab. Me prejardhje nga Somalia, Al-Shabaab-i ka filluar të infiltrohet në xhamitë e Kenias, duke kërkuar që të mundë qeverinë. Gjoni dukej i tronditur nga planet e liga dhe të pacipa të Al-Shabaab-it. Mundosha për një përgjigje, por më pas ndjeva udhëzimin e Perëndisë:

“Gjon, së pari, ti nuk je përgjegjës që të zbulosh se si ta ndalosh

Al-Shabaab-in. Ti je përgjegjës për të punuar për paqen kudo që Perëndia të ka vendosur.

Perëndia të ka dhënë një sferë ndikimi. Fillo aty. Jepu zemër të krishterëve që t’i fitojnë myslimanët me dashuri.”

Së dyti, unë thashë: “Gjon, ti duhet të gjesh paqebërës fisnikë myslimanë. Ti duhet të bashkëpunosh me ta që t’i fitosh zemrat dhe mendjet e miqve të tyre myslimanë dhe t’i kthesh kundra Al-Shabaab-it.”

Përgjigjja ime thekson dy çelësa të cilët na ndihmojnë të përballemi me ekstremizmin e dhunshëm dhe të kërkojmë paqen me myslimanët:

1. Paqja fillon me mua. Çfarë pret Perëndia prej meje në sferën time të ndikimit?

Jezusi tha se fëmijët e Tij do të jenë paqebërës (Mateu 5:9). Pali tha se paqebërja është e gjerë në qëllimin e saj: “Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me të gjithë njerëzit.” (Romakëve 12:18, shih edhe Hebrenjve 12:14). Pikërisht, me të gjithë – përfshi myslimanët.

Thomas Davis pati jetuar në Padang, në ishullin e Sumatras, në Indonezi. Për shkak të kësaj, ai u ftua të fliste së fundmi në Universitetin Muhamadiah atje. Ai e filloi fjalimin e tij me një apologji. “Kam ardhur nga Amerika për të kërkuar falje, sepse ne të krishterët amerikanë nuk i kemi dashur fqinjët tanë myslimanë në Amerikë ashtu si na ka urdhëruar Jezusi.” Turma e habitur ishte ulur me zell për të dëgjuar më tepër. Pra, Thomas-i foli për mësimin e Jezusit mbi dashurinë dhe pajtimin,

duke theksuar se ku kishin dështuar ndjekësit e Jezusit në Amerikë.

Ai më pas vazhdoi me disa lajme të mira. "Ka një rritje në numër të të krishterëve në Amerikë, ashtu si ata prej nesh në Katalizatorin Ndërkombëtar të Paqes, të cilët duan të jetojnë sipas mësimëve të Jezusit." Ai shpjegoi se si ai e bën këtë duke dhënë shembuj praktikë të vetë punës së tij paqebërëse me myslimanët në qytetin e Raleigh-it.

Kur Thomas-i mbaroi fjalimin e tij, një profesor mysliman prej një universiteti tjetër u çua dhe dha një sfidë plot pasion: "Thomas-i ka ardhur nga Amerika për të sjellë një mesazh prej Perëndisë. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij janë duke modeluar një mënyrë më të mirë jetese për myslimanët indonezianë. Myslimanët indonezianë duhet të mësojnë që t'i trajtojnë të krishterët indonezianë me mirësi dhe me respekt. Ne duhet të ndjekim shembullin e Thomas-it që t'i shërbejmë minoritetit, duke mësuar prej tyre dhe duke ndërtuar miqësi me ta."

Thomas-i thjesht po përpiqej të ishte besnik dhe të tregonte historinë e tij. Ai punoi për paqen brenda sferës së tij të

ndikimit. Rezultati? Historia e tij mbolli fara për paqen dhe liri më të madhe fetare në Indonezi.

2. Të krishterët duhet të bashkëpunojnë me myslimanët për të kundërshtuar terrorizmin dhe për të promovuar lirinë fetare.

Douglas Johnston dhe organizata e tij Qendra Ndërkombëtare për Besimin dhe Diplomacinë (www.icrd.org), bashkëpunojnë me myslimanët për të promovuar lirinë e besimit dhe për të kundërshtuar terrorizmin në Pakistan.¹

Gjatë dhjetë viteve të kaluara ata kanë punuar me drejtuesit myslimanë të medreseve (shkollave fetare) për të zgjeruar programet e tyre mësimore për të përfshirë shkencën, së bashku me një theks të fortë mbi tolerancën fetare dhe të drejtat e njeriut.

Johnston-i vëren me mençuri: "Bombat kryesisht krijojnë më shumë

terroristë duke e acaruar më tej ciklin e hakmarrjes. Nga ana tjetër, edukimi edhe than kënetat e ekstremizmit, edhe siguron një të ardhme më të mirë për fëmijët e Pakistanit (dhe, në mënyrë indirekte, edhe atë tonën)."²

Mendoni pak për këtë: Të krishterët dhe myslimanët përbëjnë mbi gjysmën e popullsisë së botës. Nëse ne nuk mund të arrijmë paqen midis tyre, atëherë do të jetë praktikisht e pamundur të kemi paqe në botë.

Bibla thotë: "të kërkojë paqen dhe t'i bjerë pas asaj" (1 Pjetrit 3:11). Unë do të shtoja: në sferën tuaj të ndikimit dhe në bashkëpunim me paqebërësit myslimanë. Këto dy çelësa do të bëjnë që të çlirohet paqja!

Pra, lutuni që të krishterët do të ndjekin shembullin e Princit të Paqes. Lutuni që Perëndia të ngrejë mijëra paqebërës myslimanë me të cilët të mund të bashkëpunojmë.

Për të mësuar më shumë mbi paqebërjen, shihni librin e Rick-ut, *Katalizatorët e Paqes: Zgjidhje e Konfliktit në Familjet, Organizatat dhe Komunitetet tona*. Ose na vizitoni në www.peace-catalyst.net.

¹ <http://peace-catalyst.net/blog/post/peacemaking-in-pakistan-promoting-religious-freedom>

² Paqebërësit Ungjillorë, David Gushee (ed) (2013), f. 57/ <http://amzn.to/Uf11HL>

Uzbekofonët e Kirgistanit të Jugut

Janë rreth 800 000 uzbekofonë në Kirgistanin e Jugut, përfshi ujugurët dhe turqit, po ashtu edhe uzbekët etnikë. Shumica e këtyre popujve jetojnë pranë kufirit me Uzbekistanin, në pjesën e Kirgistanit të Luginës Fergana. Ky rajon i pasur bujqësor



është një prej zonave me popullsi më të dendur në Azinë Qendrore. Konkurrenca për tregtinë, tokën dhe ujin shpesh ka qenë një pikë konflikti, veçanërisht midis grupeve të ndryshme etnike.

Gjatë dekadës së kaluar, ka pasur një rritje të ndjenjës së atdhetarisë kirgistaneze, e cila ua ka bërë jetën të vështirë minoriteteve uzbekofone. Ky presion është shtuar që prej kryengritjeve ndëretnike në vitin 2010, me diskriminim në sferat ligjore dhe politike, dhe humbje të mundësive ekonomike. Pothuajse të gjithë uzbekofonët e identifikojnë veten si myslimanë, por së fundi ndikimi i islamit është rritur, i shoqëruar me një rritje të fundamentalizmit.

Së jashtmi, më shumë njerëz po e gjejnë identitetin e tyre tek islami, por disa po e kërkojnë me sinqeritet Perëndinë. Nadimi është një uzbekofon, i cili jeton në Kirgistanin rural me gruan e tij dhe pesë fëmijët. Ai ka vuajtur nga makthet periodike për mbi 20 vjet, duke kërkuar trajtim prej shumë mjekësh dhe psikologësh. Nadimi e dinte se duhej një mrekulli

që makthet e tij të mbaronin, dhe po konsideronte një udhëtim për në Mekë kur ai takoi besimtarët me të cilët mundi të lutej për veten dhe familjen e tij. Ëndrrat e këqija vazhduan herë po e herë jo, por sa herë që dikush lutej për të në emrin e Jezusit ai bënte një gjumë shumë të patrazuar natën. Tashmë ai është i lirë prej të gjithë këtyre maktheve. Që prej kohës kur mori një Dhiatë të Re, Nadimi e mban atë në xhepin e tij. Nëpërmjet zellit që ai ka për studimin e Shkrimeve, e gjithë familja e tij dhe rrjetet e tyre gjithashtu kanë mundësinë për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për kërkuesit si Nadimi, që ata të takohen me Jezusin nëpërmjet besimtarëve, nëpërmjet shenjave dhe mrekullive, dhe nëpërmjet Fjalës së Perëndisë.*
- *Lutuni që jo vetëm individët, por gjithashtu edhe familjet, dhe të gjithë rrjetet të vijnë në Mbretëri.*
- *Lutuni për drejtësi dhe shpresë për minoritetet uzbekofone në Kirgistanin e Jugut.*

Turkistani: Krishti i gjallë

Turkistani është toka e 200 milionë turkistanezëve, të cilët përbëjnë 227 grupe etnike turkistanezë ndër 15 kombe. Ai shtrihet në 6 400 km, përtej stepave të Azisë Qendrore, nga vendi i tij prej origjinës etnike në Malet Altai, në kufirin perëndimor të Mongolisë, nëpër rajonin e trazuar të Kaukazeve, para derdhjes në Turqinë e ditëve tona dhe në shtetet ballkanike të Evropës.

Që prej pushtimit otoman të Kostandinopojës në vitin 1453, turkistanezët myslimanë e kanë deklaruar Turkistanin si një fortesë islamike. Gjithsesi, gjatë dy dekadave të shkuara Fryma e Perëndisë ka qenë duke lëvizur në Turkistan, duke i

tërhequr mijëra turkistanezë të Azisë Qendrore drejt një jete të re në Jezu Krishtin.

Ky rizgjim filloi në vitet 1940, kur Josif Stalin shpërnguli mijëra ungjillorë etnikë gjermanë në Azinë Qendrore. Duke pasur frikë nga prania e tyre pranë rreshtave të parë të luftës me Gjermaninë, ai synoi që t'i mërgonte ata në humbëtitrat e Turkistanit. Padashur, ai i pozicionoi ata në mes të një prej qendrave të myslimanëve në tokë.

Pas rrëzimit të Perdes së Hekurt, në vitin 1989, mijëra misionarë ungjillorë të Perëndimit hynë në Azinë Qendrore për herë të parë, duke sjellë me vete përkthime të Biblës, media të ungjillit të krishterë, dhe shërbesa që përçonin dashurinë dhe mëshirën e Jezu Krishtit.

Sot, shumë kisha janë mbyllur dhe shërbesat perëndimore janë përjashtuar, por besimtarët me prejardhje myslimane të Turkistanit, sidoqoftë, mblidhen në bashkësi të fshehura, dhe në qetësi ndajnë dashurinë dhe fuqinë e ungjillit me miqtë dhe familjet e tyre.

Kur pyeten se çfarë përdori Perëndia për t'i sjellë ata në besimin te Jezu Krishti, besimtarët me prejardhje

myslimane të Turkistanit cilësonin rolin e ëndrrave, rëndësinë e të pasurit të Dhiatës së Re në gjuhën e tyre, shikimin filmit të Jezusit, dhe faktorë të tjerë. Por fija më e rëndësishme, e cila lidhte çdo dëshmi, ishte zbulimi i një Krishti të gjallë, i Cili i dëgjonte dhe u përgjigjej lutjeve të tyre. Ndryshe nga ofertat boshe të komunizmit, islamit kulturor, ose ateizmit shekullar, Krishti i gjallë pati prekur një vend të thellë në shpirtat e tyre, ashtu si asgjë tjetër nuk e kishte mbushur më parë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për besimtarët dhe kishat me prejardhje myslimane të Turkistanit.*
- *Lutuni që shtypja e tashme e misioneve të krishtera në Turkistan t'i drejtojë besimtarët me prejardhje myslimane të Turkistanit që të ungjillëzojnë me më shumë guxim.*
- *Lutuni për mijëra fshatra të Turkistanit, të cilat nuk kanë asnjë lloj dëshmie të ungjillit.*

TURKISTANI

Kombe	15
Grupe etnike myslimane	227
Popullsia gjithsej	203,251,345
Popullsia myslimane	159,225,454



Bosnjë-Hercegovina: kultura, konflikti dhe kryqi

Vendi i bukur i Bosnjë-Hercegovinës ka qenë territori për një nga luftërat më shkatërruese të shekullit XX. Nëse ecni lart e poshtë rrugëve të Sarajevës sot, do të shikoni muret e tejshtëruara prej plumbave, të cilat të kujtojnë luftën rreth 4-vjeçare që duroi ky vend. Një nga episodet më vdekjeprurëse në këtë luftë ishte ekzekutimi i 8 000 burrave dhe djemve myslimanë boshnjakë nga forcat serbe në qytetin e Srebrenicës. Nacionalizmi fetar në Bosnjë-Hercegovinë u bë idhulli që solli këtë shkatërrim të egër. Luftërat etnike e bëjnë



predikimin e ungjillit gjithmonë e më shumë sfidues. Rrënjët e këtij konflikti shtrihen pas në vitin 1389, kur një ushtri myslimane turke fitoi mbi serbët etnikë. Në vitet 1990, kur komunizmi ra, këto rivalitete të vjetra etnike u shfaqën sërish. Luftimet shpërthyen përsëri në mes të serbëve (që janë të krishterë ortodoksë), kroatëve (katolikë) dhe boshnjakëve myslimanë. Feja u përdor nga të gjitha anët, dhe kryqi i Jezusit simboli më i lartë i dashurisë, u ngrit si një standard nga të dyja forcat, kroatët katolikë dhe serbët ortodoks.

Lufta që jashtëzakonisht e ndërlikuar, dhe shumë krime u kryen nga të gjitha anët. Kjo nuk ishte një luftë fetare, por feja i përcaktoi grupet e ndryshme etnike.

Krishterimi u përdor si një justifikim për luftën dhe një arsye për të luftuar. Sa ndryshe është kjo nga ajo që Jezusi i tha një populli që gjendej nën pushtimin brutal romak: "Duajini armiq të tuaj". Sa ndryshe ishte ky fetarizëm fisnor nga ajo që Jezusi i tha se ishte e parëndësishme se në cilin mal adhuronin. Ajo që ishte e rëndësishme ishte se duhet ta adhurojmë

Atin në frymë dhe në të vërtetë (Gjoni 4:21-24).

Si mund të presim që myslimanët në Bosnjë-Hercegovinë të kthehen në besimin e atyre që kanë kryer masakrën e Srebrenicës? Si mund ta kuptojnë ata të vërtetën e asaj që Jezusi bëri në kryq kur kjo e vërtetë është njollosur në këtë mënyrë nga lufta? E megjithatë myslimanët e Bosnjë-Hercegovinës kanë dëshpërimisht nevojë që të takohen me Jezusin.

SI MUND TË LUTEMI?

- Që ndjekësit e Jezusit në Bosnjë-Hercegovinë të jenë dëshmitarë të guximshëm të bukurisë së ungjillit hirplotë të Jezusit.
- Që myslimanët e rinj të Bosnjës të jenë të mbrojtur nga islamizmi ekstrem dhe të krijojnë një uri që vetëm Jezusi mund ta shuajë.
- Lutuni që të shohin ëndrra me Jezusin.
- Lutuni për një pajtim të thellë që do të përshkojë këtë tokë, duke bërë që njerëzit të kthehen te Jezusi, tek i Cili nuk ka çifut as grek, kroat, serb, boshnjak apo katolik.

Azia Jugperëndimore: ndryshimi po vjen

E përbërë nga Afganistani, Pakistani dhegjysma perëndimore e Indisë, Azia Jugperëndimore përfshin përçarjet rivale të qytetërimeve hinduiste, turke, persiane dhe dravidiane, të cilët kanë nxjerrë breza konfliktesh në mes të këtij rajoni, ku ndodhen 315 milionë myslimanë në 186 grupe të ndryshme etnike.

Ndryshe nga disa vende të tjera në botën myslimane, ku gratë dhe vajzat i nënshtrohen *perçes* (fshehja e graas në publik si një nder ndaj vlerës së tyre të madhe), myslimanët fisnorë në brendësinë e largët të Azisë Jugperëndimore nuk ushqejnë iluzione të tilla. Ata e vlerësojnë gruan thjesht si një pronë. Një besimtar me prejardhje myslimane shpjegon: “Në

kulturën tonë gratë janë si këpucët. I përdorim dhe, kur vjetrohen, i hedhim poshtë. Në qoftë se një grua nuk e kënaq burrin e saj ai e tërheq zvarrë dhe e çon në varreza për ta futur të gjallë në dhe.”

Mes besimtarëve në Azinë Jugperëndimore kjo gjë po ndryshon.

Kjo gjë mori një pikë kthese kur dy misionare amerikane organizuan një seminar për një duzinë grash nga fshatrat fisnore myslimane. Ndodhi që në momentin e fundit në vend të grave erdhën burrat e tyre!

Dona, një nga mësueset, kujton: “Dita e parë ishte një dështim i plotë. Burrat fisnorë ishin të tmerruar nga mendimi nëse dy gra mund t’u mësonin ndonjë gjë atyre”.

Gjatë një bisede të tensionuar me gratë amerikane, Ahmedi rastësisht pyeti: “A nuk duhet t’i rrahim gratë tona, çfarë thotë Bibla për këtë?”. Një diskutim i sinqertë ndoqi më pas bisedën me Donën, e cila duke e vënë theksin te Shkrimi i Shenjtë u tregonte se si burrat duhet t’i trajtonin gratë e tyre me dashuri sakrifkuese.

Mëngjesin tjetër Ahmedi tha: “Nuk

vumë gjumë në sy gjithë natën, duke biseduar në lidhje me ato që kishte thënë Jezusi për gratë dhe se si duhet t’i trajtojmë bashkëshortet tona. Një nga të gjithë burrat u ngrit në këmbë dhe tha: “Unë nuk do ta rrah më gruan time. Duke filluar nga sot, do ta trajtoj atë me respekt.”

A mund të ishte kaq e lehtë? Nuk ka qenë e lehtë, rrëfen Ahmedi: “Ky ishte një ndryshim shumë i madh për të gjithë ne”.

Pas këtij seminari filloi “lëvizja e graas”, e cila ka bërë që të nisin qindra kisha. Burrat kërkuar më shumë mësimë në lidhje me gratë. “Vitin e kaluar, - tha Ahmedi, - më shumë se 100 drejtues kishash, më kanë thënë: ‘Unë nuk e godas më gruan time’.”

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që t’i jepet fund luftës, konflikteve, vrasjeve dhe padrejtësisë në Azinë Jugperëndimore.*
- *Lutuni për rritjen e vazhdueshme të besimtarëve të rinj në Krishtin.*
- *Lutuni që Perëndia të bëjë që lëvizje të tjera besimi dhe jete të re në Krishtin të lindin mes myslimanëve.*



BOTA E AZISË JUGPERËNDIMORE

Kombe	3
Grupe etnike myslimane	186
Popullsia gjithsej	713,922,175
Popullsia myslimane	315,998,874

Shaikhët marathifolës

Ka mbi 200 milionë myslimanë shaikhë në botë, shumica e të cilëve jetojnë në Indi, Pakistan dhe Bangladesh. Myslimanët shaikhë përbëjnë shumicën e popullsisë myslimane sunite në rrafshnaltën Deccan të Indisë Qendrore. Shaikhët që flasin marathi, janë njerëz nga zonat rurale, të cilët jetojnë kryesisht në shtetin e Maharashtrës, ku marathi është gjuha zyrtare. Popullsia e përgjithshme e shaikhëve marathifolës është 2.5 milionë.

Termi “shaikh” që dikur u referohej fiseve me prejardhje të pastër arabe, tani mbulon popujt specifik islamë në Indinë Qendrore dhe Jugore, të cilët vinin nga kastat e ulëta hinduiste dhe që u kthyen në besim tre ose më shumë breza më parë, gjithashtu edhe për ata në veri të Indisë të cilët kthehen në besim nga kastat e larta hinduiste përmes punës së misionarëve sufistë islamikë.

Ndonjëherë komunitetet indiane “shaikhe” dallohen nga myslimanët e tjerë, por shpesh ata janë të përzier. “Shaikhët” nuk kanë profesione tradicionale. Në zonat rurale ata janë të punësuar në përgjithësi në bujqësi.

Në zonat urbane ata janë të arsimuar relativisht mirë dhe, në këtë mënyrë janë të punësuar në tregti dhe në sektorët shtetërorë dhe të shërbimeve private. Pothuajse të gjithë shaikhët janë myslimanë suni, megjithëse praktikat e tyre mund të jenë joortodokse. Në tërësi islami në Indi përfshin elemente të forta të misticizmit. Nderimi i shenjtorëve myslimanë lokalë është shumë i zakonshëm, varret e tyre janë të zbuluar në mënyrë ekstravagante, muzika dhe adhurimi i përkushtuar zënë vend atje.

Ata kanë një ndjenjë të thellë të përkushtimit ndaj Allahut.

Mësimet sufiste kanë bërë që shumë shaikhë të besojnë në universalizëm - se të gjitha shtigjet fetare, në fund të fundit, të çojnë tek Allahu.

Shaikhët marathifolës festojnë shumicën e festivaleve dhe festave të shenjta myslimane. Fëmijët marrin arsimin bazë fetar. Gjatë viteve të fundit klasat e mesme indiane gjithnjë e në rritje kanë qenë në gjendje t’u sigurojnë fëmijëve të tyre mundësitë që të vazhdojnë edhe arsimin e lartë. Me zhvillimet e fundit ekonomike disa

“
Ata kanë një ndjenjë të thellë të përkushtimit ndaj Allahut.”

janë ndikuar thellësisht nga laicizmi dhe materializmi.

Nuk ka asnjë Bibël ose literaturë të lidhur me versionin shaikh të gjuhës marathi, edhe pse në gjuhën tradicionale marathi Bibla është gjerësisht e disponueshme.

Shumë gjithashtu flasin urdu ose hindu; Bibla dhe filmi i Jezusit janë në dispozicion në këto gjuhë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që fermerët shaikhë marathifolës që dëgjojnë ungjillin, ta kuptojnë dhe të përgjigjen me besim.*
- *Lutuni për besimtarët e rinj mes marathifolësve shaikhë, që të themelohen te Fjala e Perëndisë dhe që çdo ditë të rriten në besim, dashuri dhe bindje ndaj Perëndisë.*
- *Lutuni për mënyra krijuese për t’i arritur shaikhët marathifolës që janë analfabetë.*
- *Lutuni që Perëndia të sigurojë mjetet (shkrime, audio, histori, etj), si edhe rrugët për shpërndarjen masive të këtyre materialeve.*

DITA 19

E hënë,
6 korrik

Azia
Juglindore

Azia Juglindore: Një Bibël e jona

Azia Juglindore është si një sallë e mbushur me më shumë se 800 milionë banorë, prej të cilëve afro 250 milionë janë myslimanë. Salla përqendrohet rreth popullit bengali të Bangladeshit dhe të shtetit të Indisë së Bengalit Perëndimor, por gjithashtu përfshin edhe 64 grupe të tjera të popujve myslimanë. Në mes të gjithë kësaj, Fryma e Shenjtë është duke i dhënë jetë të re në Jezu Krishtin lëvizjeve të shumta mes myslimanëve.

Kur misionari Uilliam Keri (William Carey) botoi Biblën e parë në Bengali

në vitin 1809, shumica e bengalëve ishin hinduistë ose myslimanë. Keri e dinte që zgjedhja e fjalorit që ai do të përdorte do ta anonte Biblën nga popullsia hinduiste ose nga ajo myslimane.

Ai zgjodhi të anohej nga hinduistët duke zgjedhur fjalën 'Ishuar' të bazuar në gjuhën sanskritishte për të përkthyer fjalën 'Perëndi' në vend të Allahut ose Khoda, fjalë të cilat përdorshin nga myslimanët.

Gjatë 170 viteve të ardhshme, zgjedhja e Kerit i bindi myslimanët se të krishterët adhuronin ndonjë zot tjetër, që ka shumë mundësi të jetë nga panteoni hinduist. Në fillim të viteve 1970, kur përkthyesit prodhuan pjesët e para të ungjillit të kontekstualizuar në përkthimin mysliman, ata përshtatën fjalën 'Khoda' për 'Perëndi' - një fjalë nga gjuha urdu që përdoret zakonisht prej myslimanëve dhe të krishterëve në lindje dhe perëndim të Pakistanit.

Në vitin 1971, pas luftës çlirimtare nga Pakistani Perëndimor, bangladeshasit e distancuan veten nga fjala në urdu dhe filluan të përdorin emrin 'Allah' për Perëndinë. Duke kërkuar që të komunikonin me myslimanët, kur përkthyesit bënë botimin e plotë të *Biblës në gjuhën e përbashkët bengali* në vitin 2000, ata zgjodhën fjalën 'Allah' për Perëndinë. Edhe pse të krishterët në perëndim e lidhin emrin e Allahut me islam, në fakt, ai është me origjinë të krishterë. Përkthyesit e dinin se çfarë i dallonte të krishterët nga myslimanët, nuk është emri që ata përdorin për Perëndinë, por kuptimi i tyre teologjik rreth Perëndisë, dhe se e vetmja



Fryma e Shenjtë është duke u dhënë jetë të re në Jezu Krishtin lëvizjeve të shumta mes myslimanëve”



mënyrë për ta korigjuar këtë mënyrë të kuptuari ishte duke u dhënë Biblën e plotë në gjuhën e tyre.

Me daljen e *Biblës për myslimanët bengali*, shumë myslimanë nga Azia Juglindore po e lexojnë Biblën dhe kështu po kuptojnë që Perëndia i Biblës nuk është një hyjni hinduiste, por i Vetmi Perëndi që i deshi aq shumë sa dha Birin e Tij si sakrificë dhe si Shpëtimtar për mëkatet e tyre.

SI MUND TË LUTEMI?

- Lutuni që shumë myslimanë në Azinë Juglindore do të takohen me Perëndinë e Biblës përmes përkthimeve të reja lokale.
- Lutuni për dashuri dhe harmoni mes të krishterëve me prejardhje myslimane dhe jomyslimane.
- Lutuni për miliona myslimanë në Azinë Juglindore, të cilët nuk kanë dëgjuar asnjëherë për ungjillin e Jezu Krishtit.



AZIA JUGLINDORE

Kombet	4
Grupet etnike myslimane	65
Popullsia gjithsej	844,398,260
Popullsia myslimane	283,393,591

Kanpuri: “Mançesteri i Lindjes”

I vendosur në brigjet e lumit Ganges, Kanpuri është një nga qendrat më të mëdha industriale dhe arsimore në veri të Indisë. Me një popullsi rreth katër milionë banorë, Kanpuri është qyteti më i madh në shtetin e Utar Pradeshit.

Hinduizmi është feja më e spikatur, por rreth 20 për qind e popullsisë janë myslimanë, shumica e të cilëve janë të varfër dhe analfabetë. Dhuna dhe

trazirat në komunitet janë të zakonshme, dhe shumë myslimanë duket se nuk kanë asgjë për të humbur, përveç jetës së tyre.

Kanpuri ka një histori të gjatë dhune. Ka qenë skena e disa prej betejave më të

paharrueshme të Indisë për liri dhe të përlëshjeve në mes të njerëzve të politikës, kulturave dhe feve të ndryshme.

Lufta e parë për pavarësi, e quajtur gjithashtu kryengritja “Sepoi” (Sepoy) e Indisë në vitin 1857, ishte kryengritja e parë e përhapur kundër Kompanive Britanike të Indisë Lindore.

Rreth 300 britanikë u vranë në vendin e quajtur tani Masakra e Vargmalit, e ndjekur nga një tjetër masakër në Bibighar, ku rreth 120 gra dhe fëmijë britanikë i gjymtuan dhe i hodhën në një pus të thatë – si kundërpërgjigje, disa historianë besojnë, në bazë të raportimit të lajmeve mbi dhunën nga ana e forcave të Kompanive Indiane të Lindjes, se forcat shpëtuese erdhën prej Allahabadit.

Trazirat në komunitet dhe bandat kriminale e kanë njoollur të shkuarën e Kanpurit. Incidenti i njohur si Xhamia e Kanpurit në vitin 1913 u bë simboli i parë i politikës kombëtare myslimane indiane. Britanikët kërkuan prishjen/lëvizjen e objekteve të larjes në xhami për të ndërtuar një rrugë. Kjo gjë u pa si një kërcënim për islam, kështu që u formuan komitete dhe si pasojë erdhën edhe trazirat.

Në vitin 1931, Ganesh Shankar Vidiarhi (Ganesh Shankar Vidyarthi), aktivist i lëvizjes për pavarësi (themelues dhe redaktor i gazetës revolucionare hinduiste “Pratap” dhe udhëheqës i Kongresit Kombëtar Indian), vdiq në trazirat myslimane-hinduiste ku mbetën

të vrarë rreth 166 persona dhe 480 të tjerë u plagosën.

Në vitin 1992, Kala Baka (“fëmija i zi”), një kriminel i njohur aleat i partisë politike “BJP”, ishte aktiv në trazirat në Kanpur, duke u përfshirë gjithashtu edhe në prishjen e xhamisë “Mesxhid Babri” në Ayodhya (200 km larg nga Kanpuri). Në vitin 2001, prishja e statujës së Budës së Bamiyanit (Bamiyan) në Afganistan, e cila u pasua edhe me djegien e Kur’anit nga hinduistët në Delhi, shkaktoi trazira në Kanpur, në të cilat u përfshinë edhe anëtarët e Lëvizjes Studentore Islame të Indisë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Perëndia dëshiron të restaurojë paqen në Kanpur. Lutuni për pajtim mes grupeve fetare.*
- *Lutuni që dashuria dhe mëshira e Perëndisë të shfaqet përmes të krishterëve të pakët që jetojnë në Kanpur dhe që “trupit i Tij” të rizgohet dhe të mbushet me dashurinë e Perëndisë.*
- *Lutuni që Perëndia të dërgojë më shumë punëtorë që të sjellin mesazhin e Princit të Paqes.*

Indo-Malajzia: tri valë

Dhoma Indo-Malajziane në Shtëpinë e Islamit shtrihet nga Gadishulli Malaj përmes arkipelagut indonezian dhe deri te kombet rrethuese të Singaporit, Bruneit, Filipineve dhe Tajlandës Jugore. Ajo është shtëpia e më shumë se 200 milionë myslimanëve. Kthimi i myslimanëve të sotëm në të krishterë filloi në vitin 1870, me shërbesën e një indoneziani me prejardhje myslimane, i quajtur Sadrak Surapranada.

Që prej vitit 1873, Sadraku pa më shumë se 2 500 myslimanë javanezë të ktheheshin në besimin e Jezu Krishtit, diçka që asnjë i krishterë nuk e dëshmon në vitet 1238, deri kur vdiq profeti Muhamed. Kur ai vdiq në vitin 1924, numri i besimtarëve indonezianë me prejardhje myslimane ishte përafërsisht nga 10-20 000 të krishterë të pagëzuar.

Kthimi i myslimanëve në të krishterë në këtë rajon ndahet në tri valë. E para ishte depërtimi pionier i Sadrakut. E dyta ndodhi në vitet 1967-1971 kur një polic komunist udhëhoqi në shtypjen e dhunshme komuniste, dhe çdo indonezian ishte i detyruar

të deklaronte besnikëri ndaj një prej 5 besimeve kombëtare: islamit, hinduizmit, budizmit, katolicizmit ose ungjillorëve. Një gjysmë milion indonezianë u vranë nga besnikët e forcave islamike, kjo bëri që 2.8 milionë indonezianë t'i bashkoheshin besimit ungjillor, ndoshta ky është kthimi më i madh në histori, i myslimanëve në të krishterë.

Vala e tretë është duke ndodhur tani. Rritja e kishës në Indonezi është më pak dramatike se atëherë, por e njëjtë në mënyrën e përhapjes. Në dhomën e Indo-Malajzisë, gjithmonë e më shumë myslimanë, janë duke dëgjuar ungjillin e Jezu Krishtit. Depërtimi po ndodh përmes prezantimit përtëritës të ungjillit, shpalljes plot guxim të ungjillit të kontesktualizuar dhe dëshmisë besnike të të krishterëve lokalë, të cilët tani janë përhapur në çdo qoshe të kësaj dhome të populluar në Shtëpinë e Islamit.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që ungjilli të vazhdojë të arrijë çdo qoshe të dhomës Indo-Malajziane.*

- *Lutuni që myslimanët të vijnë në besimin e Krishtit, ndërsa përjetojnë persekutimin, dhe të marrin një hap guximi drejt Jezu Krishtit.*
- *Lutuni për të krishterët dhe misionarët të cilët me kurajë dhe përtëritje vazhdojnë të arrijnë rajonet e 282 grupeve etnike myslimane.*

INDO-MALAJZIA

Kombet	6
Grupet etnike myslimane	282
Popullsia gjithsej	283,696,115
Popullsia myslimane	201,000,020



Populli patani malaj (Pattani Malay) i Tajlandës

Populli patani malaj është një grup etnik, një komunitet i devotshëm mysliman, pasardhës të popullit malaj që jeton në Tailandën e Jugut. Numri i tyre arrin në 3.5 milionë njerëz.

Njerëzit patani malaj kanë kulturë të pasur dhe janë mjeshtër shumë të aftë. Këto aftësi mund t'i shohësh në varkat plot ngjyra të peshkimit, të cilat quhen 'Korlae', dhe në zejtari të tjera. Shumë nga ata e fitojnë jetesën përmes peshkimit, punës në fabrikat e peshkut, nxjerrjes së kauçukut nga trumbu i drurëve tropikalë, ose përmes punës në fermë me perimet dhe frutat.

Gjithsesi, në përgjithësi myslimanët në Tailandën e Jugut fitojnë më pak se paga minimale.

Shumë prej tyre kanë ngecur në ciklin e varfërisë që përkeqësohet nga të ardhurat e ulëta dhe nga shkalla e lartë e lindjeve. Provincat ku jetojnë shumica

e njerëzve patani

malaj, janë shumë larg nga qendra e qeverise tajlandeze, ndaj ky popull ka zhvilluar një ndjesi veçantie dhe pavarësie.

Gjithsesi, sa herë që qeveria përpiqet të centralizojë kontrollin në provincat e tyre, kjo pavarësi kërcënohet duke rezultuar në një kundërshtim ndaj qeverisë.

Shumica e njerëzve patani malaj flasin në dialektin malaj. Tai është një gjuhë që flitet rrallë në fshatra, edhe pse përdoret në shkollë dhe në zyrat e qeverisë ose me budistët tajlandezë. Patani malaj mbetet gjuha e tyre e zemrës.

Njerëzit patani malaj jetojnë zakonisht në komunitete ku janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe pranimiti shoqëror është i rëndësishëm. Të rinjtë janë ndikuar shumë nga TV dhe filmat, prandaj varësia ndaj drogës dhe imoraliteti janë në rritje. Problemet ekonomike dhe politike janë të pranishme në ato ambiente, kjo shpesh minon jetën e tyre tradicionale. Populli patani malaj jeton në një kohë krize, dhe dhuna si përgjigje ndaj paqëndrueshmërisë po bëhet një shqetësim në rritje.

Ndryshe nga shumica e popullsisë së Tajlandës, të cilët janë budistë, populli patani malaj është mysliman. Pavarësisht gjithë ndryshimeve të fundit dhe krizave që kanë përjetuar këta njerëz, islami ka qenë i qëndrueshëm. Që prej fillimit të mbretërisë së hershme malaj në Tajlandë, islami ka pasur një ndikim të madh në kulturën e tyre. Ata i përkrahin me kujdes ligjet e islamit, ose ligjin *sharia*, e cili mësohet në shkollat tradicionale islamike që quhen "Pondoks". Për shkak të dedikimit ndaj besimit islamik, populli patani malaj ka një identitet të dallueshëm në Tajlandë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Për zhvillimin e mundësive për arsimim të përballueshëm nga ana financiare, të cilat do të theyjnë ciklin e varfërisë për popullin patani malaj.*
- *Që më shumë njerëz patani malaj të lexojnë dhe të dëgjojnë historinë e Jezusit, dhe të përjetojnë fuqinë e Tij transformuese.*
- *Kërkojini Frymës së Shenjtë t'u japë urtësi dhe përkrahje agjencive misionare dhe punëtorëve të fokusuar te ky grup njerëzish.*



Urat e Perëndisë në botën myslimane (pjesa e parë)

Gjatë një studimi, më shumë se një mijë besimtarëve me prejardhje myslimane të kthyer në Krishtin përgjatë gjithë Shtëpisë së Islamit, iu bë kjo pyetje: “Çfarë përdori Perëndia për të të sjellë në besimin e Jezu Krishtit?” Përgjigjet e tyre zbuluan dhjetë kuptime të thella për urat e Perëndisë. Më poshtë janë pesë të parat:

(1) Besimi

Përmes besimit, brezat e hershëm të misionarëve të krishterë hynë në Shtëpinë e Islamit të shpallnin një ungjill që ishte përballur me një rezistencë të fortë. Shumë nga këta misionarë nuk i panë kurrë lëvizjet që po ndodhin sot – “ata vetëm i panë dhe i përshëndetën nga larg” (Hebrenjtë 11:13). Besimi i tyre ndihmoi në prodhimin e të korrave të padëgjua më parë (Hebrenjtë 12:1).

(2) Lutja

Gjatë 14 shekujve të fundit janë dokumentuar vetëm 82 lëvizje të myslimanëve drejt krishterimit. Nga

këto 69 kanë ndodhur në dy dekadat e fundit. Nuk është një rastësi që këto lëvizje bashkëkohore myslimane drejt krishterimit përkrijnë me lutjet e zjarrta që shoqërojnë “30 ditë lutje për botën myslimane”. Lutjet tuaja janë duke i hapur dyert në mënyrë efektive (Zbulesa 3:8), që myslimanët të dëgjojnë dhe t’i përgjigjen ungjillit si kurrë më parë.

(3) Shkrimet

Perëndia Premtoi se Fjala e Tij nuk do të kthehet bosh (Isaia 55:11), por deri sa Bibla të përkthehet në gjuhët e të humburve si do të kuptohet dhe besohet (Romakëve 10:14)? Më shumë shkrime janë përkthyer në gjuhën amtare të myslimanëve në këto tri dekada se në 13 shekujt e kaluar.

(4) Puna e Frymës së Shenjtë

Jezusi premtoi se Fryma e Shenjtë do të “bindë botën për mëkat për drejtësi dhe për gjykim” (Gjoni 16:8). Përpara kthimit të çdo myslimani në të krishterë përmes “Shtëpia e Islamit”, Fryma e

Shenjtë i ka bindur përmes ëndrrave, vizioneve, takimeve hyjnore dhe përmes përgjigjeve të lutjeve.

(5) Dëshmia e të krishterëve besnikë

Sot lëvizjet e myslimanëve drejt Krishtit janë rezultat i të krishterëve besnikë, të panumërt, nga çdo degë e kishës, të cilët kanë ndarë ungjillin me myslimanët.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni për një rritje të besimit, lutjes, Shkrimit, punës së Frymës së Shenjtë dhe dëshmisë së të krishterëve besnikë ndaj myslimanëve në botë.*
- *Lutuni që të krishterët do t’i kalojnë këto pesë ura që Perëndia ka siguruar për ta çuar ungjillin në Shtëpinë e Islamit.*
- *Kërkojini Perëndisë t’ju tregojë personalisht se çfarë dëshiron Ai që të bëni për t’i kaluar këto ura.*



Nuk është një rastësi që këto lëvizje bashkëkohore myslimane drejt krishterimit përkrijnë me lutjet e zjarrta që shoqërojnë “30 ditë lutje për botën myslimane”.



Refugjatët sirianë: Nuk janë ndryshe nga unë

Jusra është një 39-vjeçare, një grua siriane myslimane. Shtëpia e saj, si shtëpitë e shumë refugjatëve të tjerë, ishte prej tre brezash. Fëmijët e saj ishin shpërndarë nëpër dhomë dhe nëna e saj shumë e rrudhosur, ishte ulur mbi një jastëk në dysheme. Në një çast gruaja e vjetër filloi të shfryhej me zë të lartë për tmerrin që kishte parë dhe për dhimbjen që kishte mbushur trupin dhe shpirtin e saj. Unë hoqa mushamanë time, i kapa dorën dhe i ofrova lutje në emër të Jezusit, të Vetmit që shëron. Përcartja e saj filloi të kthehej në një



Për një çast ajo kërceu nga oqeani i saj i dhimbjes në botën tonë të vogël për të na ngushëlluar.



rënkim dhe lotët rrodhën në faqet e saj ndërsa na tregonte për bijtë e humbur.

Më pas ne vizituam familjen e saj në katin më poshtë. Xhaku filloi të fliste me burrat rreth politikës dhe luftës ndërsa gratë rreth familjes, humbjes

dhe dhimbjes. Ndërsa u ngritëm të largoheshim, gjyshja Um Ahmad më puthi, vendosi dorën e saj në barkun tim dhe u lut: “Perëndia të bekoftë me binjakë. Ai të dhëntë bekim të dyfishtë, sepse zemra jote është e pastër dhe ti u lute për familjen tonë”. Unë sapo kisha pasur një dështim. Fjalët e saj më goditën zemrën sikur të ishte lëshuar një shigjetë nga zemra e Perëndisë.

Kur i thashë se sapo kishim humbur fëmijën, ajo më kapi dorën dhe e mbajti ashtu për një kohë të gjatë. Për një çast ajo kërceu nga oqeani i saj i dhimbjes në botën tonë të vogël për të na ngushëlluar. Më pas ajo drejtoi gishtin te nusja e djalit dhe më pëshpëriti, “Ajo e humbi në të njëjtën ditë me ty. Perëndia e ktheftë mbrapsht atë që të është marrë.”

Pataj Jusra zbriti poshtë për një vizitë. Um Ahmad filloi të më bekonte mua sërish: “Perëndia të bekoftë dy herë me binjakë” Unë buzëqesha dhe vështrova Jusrën e cila kishte binjake. Ajo më tha se kishte pasur dy herë binjakë, por dy kishte humbur vitin e kaluar. Ne lejuam heshtjen të na mbulonte ndërsa pimë çajin e nxehtë dhe ndamë nga një

“filxhan” të vogël nga dhimbja e njëra-tjetrës.

Jusra e theu heshtjen e pikëllimit duke qeshur fort për diçka gazmore. Ne qeshëm; për një çast ne të gjithë, njerëz të ndarë prej kufijve, vendeve, kulturave, u ndjemë të njëjtë.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që besimtarët do të jenë dëshmi dashurie ndërsa hapin krahët ndaj refugjatëve.*
- *Lutuni për refugjatët sirianë, që të fuqizohen me shpresë dhe me ndihmë praktike, për t'u nxitur të ngrihen dhe të rindërtojnë jetët e tyre.*
- *Lutuni për shumëfishim të shpejtë të lëvizjes së kishëmbjelljes dhe që të përhapet mes refugjatëve sirianë.*



Urat e Perëndisë në botën myslimane (pjesa e dytë)

Studimi ynë, i më shumë se një mijë besimtarëve me prejardhje myslimane, zbuloi shumë ura që Perëndia po i përdor sot. Pesë të parat (shih faqen 31) nuk ishin një befasi. Pesë të tjerat ishin më pak të parashikueshme.

(6) Të mësuarit nga Trupi i Krishtit.

Sot, dishepujt e Krishtit po nxjerrin mësim se si t'i arrijnë myslimanët, nga Trupi i Krishtit që po shfaqet brenda veti shtëpisë së Islamit. Përparimet në Indonezi udhëhoqën drejt lëvizjeve të reja në Saharanë e Poshtme të Afrikës. Përqasje të reja nga Azia e Jugut po sjellin fryt në Azinë Qendrore. Ne duhet të jemi nxënës të përlulur, në mënyrë që të arrijmë botën myslimane për Krishtin.

(7) Komunikimi

Ungjilli po shpallet gjerësisht dhe me efektivitet më shumë se kurrë më parë. Përparimet teknologjike janë duke e përhapur mesazhin e ungjillit në këto dy dekada në mënyrë të paimagjinueshme. Të krishterët po përdorin përkthimet e kontekstualizuara të ungjillit, si edhe metoda të dhënies së dëshmimeve, në mënyrë që myslimanët ta dëgjojnë

ungjillin pa qenë të penguar nga barriera kulturore të atyre që e shpallin atë.

(8) Zbulesa

Historikisht, myslimanët i kanë rezistuar ungjillit, sepse u është thënë se ata janë të humbur dhe kanë nevojë për ungjillin, por kur e zbulojnë vetë këtë gjë, përmes takimit me Krishtin e gjallë, ata mbërthehen nga e njëjta fuqi e mesazhit të ungjillit që i pushton të gjithë besimtarët në çdo vend. Sfidat janë të krijuara që të krijojmë mënyra përmes të cilave myslimanët ta zbulojnë personalisht lajmin e mirë të Jezu Krishtit.

(9) Vetë islami

Kjo është një habi për shumë të krishterë, sidoqoftë shumë besimtarë me prejardhje myslimane raportojnë se leximi i Kuranit në gjuhën e tyre, në vend të arabishtes, ka qenë mënyra se si Perëndia ka zbuluar Vetën tek ata dhe u ka treguar se ishin të humbur dhe kishin nevojë për një Shpëtimtar.

(10) Indigjenizimi

Indigjenizim do të thotë “i sjellë nën zotërimin dhe ndikimin vendas”. Edhe

pse lëvizjet e myslimanëve drejt Krishtit fillojnë kur dikush që vjen nga jashtë botës së tyre u sjell lajmin e mirë, ai rrënjësohet dhe shumëfishohet atëherë kur “zotërohet” nga besimtarët me prejardhje myslimane dhe përkthehet në kontekstin e kulturës dhe botëkuptimit të tyre.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që të krishterët të vënë re rëndësinë e këtyre pesë urave dhe të ecin në to, që të çojnë lajmin e mirë në Shtëpinë e Islamit.*
- *Lutuni që këto ura të sjellin më shumë myslimanë të Krishtit.*
- *Kërkojini Perëndisë t'ju tregojë se si dëshiron Ai që t'i kaloni këto ura për t'ua çuar lajmin e mirë të Jezu Krishtit myslimanëve në komunitetin tuaj.*

“Sfidat janë të krijuara që të krijojmë mënyra përmes të cilave myslimanët ta zbulojnë personalisht lajmin e mirë të Jezu Krishtit”

Nata e Kadrit (Nata e Fuqisë): në pritje të Zotit

Myslimanët njohin shumë ngjarje historike, që kanë domethënie në historinë e besimit të tyre. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk ka të njëjtën rëndësi sesa përkujtimi i zbulesës fillestare të Kur'anit nga profeti Muhamed. Kjo ngjarje përkujtohet në Natën e Kadrit (Nata e Fuqisë), ose "Lailat Al Qadr", e njohur ndryshe edhe si "Nata e Fatit".

Historia e zbulesës së Muhamedit u tregohet fëmijëve në mbarë botën dhe është një frymëzim për ta.

Nga gojëdhënat thuhet se Muhamedi tërhiqej shpesh në një shpellë jashtë Mekës, ku ai kalonte kohë duke menduar se si të zgjidhte problemet me të cilat po përballeshin komunitetet rreth tij, sidomos ata që ishin më fatkeqë, dhe si të ngrinte zërin e tij kundër egoizmit dhe sjelljes abuzive në shoqëri.

Në muajin e Ramazanit të vitit 610 pas Krishtit, thuhet se Muhamedin e vizitoi kryeengjëlli Gabriel (Jibrili siç njihet në arabisht), i cili e ndoqi nga pas dhe e detyroi atë duke i thënë: "Iqraal", që do të thotë "Lexo!". Engjëlli e detyroi Muhamedin deri në atë pikë, sa ky i fundit mendoi se do të vdiste.

Por Muhamedi, duke qenë analfabet, iu përgjigj engjëllit duke i thënë që nuk dinte të lexonte. Engjëlli ngulmoi edhe dy herë të tjera, duke e urdhëruar Muhamedin të lexonte dhe Muhamedi ia ktheu me të njëjtën përgjigje. Thuhet atëherë se engjëlli Gabriel i zbuloi atij dy vargjet e para të Kur'anit:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i cili mëson me anë të penës, ia mëson njeriut ato që nuk i dinte". (96/1-5)

Muhamedi shkoi me nxitim në shtëpi, te gruaja e tij, Kadija (Kadijah), dhe i tregoi asaj atë që i kishte ndodhur. Ajo e nxiti të shkonte bashkë me të, të takonte kushëririn e saj, Uarakën (Waraqa), i cili ishte një studiues i shkrimeve biblike. Ai e këshilloi Muhamedin duke i thënë se ishte zgjedhur si një profet i dërguar nga Perëndia, për t'i bërë thirrje shoqërisë që të adhuronin të Vetmin Perëndi dhe të jetonin një jetë të drejtë.

Për ta kujtuar këtë ngjarje, myslimanët i kalojnë dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, në adhurim gjithnjë e më të fortë, duke recituar

vargjet e Kur'anit dhe duke bërë lutje të vazhdueshme, veçanërisht për faljen e mëkateve. Mendohet se Nata e Kadrit (Nata e Fuqisë) ka ndodhur në këtë kohë dhe ndoshta këtë natë (natën e 26-të). Ka shumë myslimanë, të cilët besojnë se lutjet që bëhen në Natën e Kadrit janë më të efektshme dhe llogariten si mijëra herë më të dobishme.

Kjo është një natë ku myslimanët presin zbulesën e Perëndisë. Le të lutemi që zbulesa e Jezusit t'u shfaqet atyre.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Shumë myslimanë kanë parë ëndrra dhe vegime të Jezusit gjatë Natës së Kadrit. Lutuni që shumë prej tyre, të cilët presin një zbulesë prej Perëndisë, të marrin zbulesën e vërtetë që vjen prej Jezusit.*
- *Lutuni për ata myslimanë të cilët janë në pritje të një zbulesë, që të kenë mundësinë të takohen me besimtarë, të cilët do t'i ndihmojnë ata të kuptojnë zbulesën që kemi për Perëndinë përmes Jezusit.*
- *Lutuni që në këtë natë pritjesh të mëdha, do të jenë të shumtë ata të cilëve Perëndia do t'u japë zbulesën e vërtetë.*

Besimi për të parë mrekullinë

Refugjatët sirianë janë dyndur drejt kufijve të sigurt të Jordanit dhe po mbushin lagjet tona. Kisha që frekuentoj së bashku me të krishterë arabë vendas, ka hapur dyert e saj për t'i pritur, dashur dhe për t'i ndihmuar këta njerëz të çmuar, të cilët kanë humbur jo pak. Ka grupe sirianësh të cilët tashmë vijnë në zyrën e kishës dhe kërkojnë që të lutemi për ta në emër të Jezusit. Ata po përjetojnë fuqinë e Tij në përgjigjet që marrin për lutjet e tyre, si dhe po rriten ndërsa hapin zemrën e tyre për Të.

Nuk ka shumë kohë që kam takuar Umm Bader, një grua myslimane siriane, të cilën çdo të diel e gjen të ulur në rreshtin e dytë të karrigeve të kishës, me kokën e saj të mbuluar dhe e pandrojtur nga fakti që duket ndryshe nga të krishterët e tjerë që ulen rreth saj. Ajo është një grua e ve, e dashur, me shpinën e saj të kërrusur dhe me duart e fishkura, që ndoshta mund t'i ketë ashtu nga vuajtjet që ka kaluar. Disa prej fëmijëve të saj nuk jetojnë më; disa të tjerë janë akoma në Siri dhe të cilët



janë gjetur për shkak të lutjeve që ajo i drejtoi Jezusit për t'i gjetur ata. Këtë grua e takova ditën kur ajo dëshmoi përpara gjithë kishës, për përgjigjet që kishte marrë për lutjet e saj. Historia e mëposhtme është një tjetër dëshmi që ajo e tregoi për t'i dhënë lavdi Jezusit:

“Para pak kohësh, dikush që quhej Isa, më erdhi në shtëpi në orën 2:30 të mëngjesit dhe më dha 100 denarë jordanez (e barazvlefshme me rreth 18 000 lekë). Unë mendova se mos ishte një burrë nga kisha që quhej Isa, por kur e takova dhe e pyeta ai më tha që padyshim ishte në shtëpi duke fjetur me gruan e tij në atë orë të vonë. Atëherë unë e kuptova se kush mund të kishte qenë. Mendja më tha që duhet të kishte qenë Isa Al-Maseeh – Jezusi Mesia.”

Në po atë mëngjes, në kishë ajo kërkoi që të bënim një lutje për nipin e saj, i cili ishte marrë nga ISIS-i për t'u gjykuar prej tyre – që do të thoshte një vdekje e sigurt për të. Më vonë ajo mori vesh që ISIS-i e kishte liruar nipin e saj (megjithëse ISIS-i kishte gjykuar dhe vrarë të tjerë përpara tij), pikërisht në atë orë të vonë kur Jezusi e kishte vizituar. Ekstremisti i ISIS-it që e gjykonte nuk

i kishte dhënë asnjë shpjegim nipit të saj; ai thjeshtë e kishte parë në sy dhe i kishte thënë të largohej. Nipi i saj ishte kthyer në shtëpi pranë nënës së tij në po atë ditë. E pashpjegueshme! Ishte një mrekulli ashiqare!

Ndodh shpesh që kjo grua, Umm Bader, me një veshje krejt të thjeshtë të një gruaje myslimane, të ngrihet me guxim në mes të kishës plot me të krishterë arabë dhe t'i japë lavdi Jezusit që i përgjigjet lutjeve të saj. Pastori ynë arab na nxiti vazhdimisht si kishë, duke thënë që të gjithë duhet të kemi besim, si Umm Bader.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që Jezusi t'u shfaqet shumë refugjatëve sirianë dhe t'u tregojë atyre që është Zoti i dashurisë dhe se pret që t'i dojë ata me një dashuri të përrjetshme.*
- *Lutuni që besimtarët e Jezusit në mbarë botën, të hapin krahët e tyre dhe të duan refugjatët, si dhe të hapin gojën për të ndarë me ta lajmin e mirë të shpëtimit.*
- *Lutuni që të përhapen ndjeshëm lëvizje për mbjelljen e kishave mes refugjatëve sirianë, të cilat do të shumëfishohen.*

Pengesat për lëvizjet

Gjatë këtyre 150 vjetëve, ne kemi parë 82 lëvizje të myslimanëve drejt Krishtit. Fakti nëse kjo valë lëvizjesh do të vazhdojë të përparojë, ngelet për t'u parë. Disa nga pengesat më të mëdha që hasin myslimanët të cilët kthehen te Krishti, gjenden pikërisht brenda vetë komunitetit të krishterë. Janë pesë pengesa të cilat duhet të hiqen që ungjilli të shpallet në mënyrë më të efektshme në botën islamike. Këto janë:

(1) Të krishterët kundërshtues

Me më shumë se 40 000 denominacione në mbarë botën sot, krishterimi është i ndarë në një mënyrë të pariparueshme, megjithatë kjo nuk do të thotë aspak që ne duhet të luftojmë me njëri-tjetrin. Ne duhet të përqendrohemi plotësisht tek ungjilli dhe jo tek ndryshimet e shumta që na ndajnë.

(2) Frika dhe urrejtja

Kur të krishterët ndihen të kërcënuar nga myslimanët, frika jonë mund të kthehet lehtësisht në zemërim dhe urrejtje. Kërcënimi islam është serioz. Islami është një ideologji totalitare që për 14 shekuj është rritur fuqishëm, duke shtypur çdo kundërshti që i dilte përpara. Por myslimanët vetë nuk janë një ideologji; ata janë njerëz, burra dhe gra, të cilët janë

të humbur dhe pa një Shpëtimtar. Vetëm Krishti dhuron "dashurinë e përsosur që e nxjerr jashtë frikën" (1 e Gjonit 4:18), dashuri e cila na fuqizon për t'i drejtuar myslimanët në mbarë botën tek Ai.

(3) Imitimi i Islamit

Islami krijoi një kulturë të shekullit të 7-të, duke e cilësuar si sistemi ideal i Perëndisë për botën. Ai i vuri shkrimet e tij në pedestal, krijoi një rrugë që njerëzit ishin të detyruar ta ndiqnin për të qenë besimtarë, i kërcënoi ata që dilnin jashtë ideologjisë së tij, madje duke i dënuar me vdekje të gjithë kundërshtarët dhe i zgjeroi kufijtë me anë të forcës ushtarake. Në mos në një kohë, në tjetrën, të krishterët janë përpjekur të ndjekin pak a shumë të njëjtën rrugë. Por këto mënyra nuk ishin kurrsesi ato të Jezusit, as rruga nëpër të cilën dishepujt e Tij duhej të ecnin. Në qoftë se duam që bota islame të vijë te Krishti, duhet të jetë vetëm sipas mënyrës së Krishtit dhe jo përmes një imitimi të gabuar të islamit.

(4) Anashkalimi i padrejtësive

Kur ushtritë arabe përparuan drejt botës bizantine, gjoja të krishterë, ata gjetën një qytetërim që kishte përkrahur krishterimin nga njëra anë, por nga ana tjetër kishte anashkaluar shumë padrejtësi, të tilla si

lejimi i institucionit të skllavërisë. Juristët islamikë, duke e parë si mundësi të favorshme këtë fakt, shpallën që asnjë skllavopronar i krishterë nuk kishte të drejtën të mbante një skllav mysliman. Kjo gjë çoi në kthimin e menjëhershëm në islam të mijëra skllavëve. Kur të krishterët "mbyllin njërin sy" për padrejtësitë shoqërore, atëherë dera për islamën është hapur.

(5) Injoranca dhe apatia

Për më shumë se 5 shekuj, të krishterët në perëndim nuk i kishin kushtuar shumë vëmendje sfidës së islamit. Por e gjithë kjo ndryshoi më 11 shtator 2001, kur injoranca dhe apatia e perëndimit u shemb përdhe me kullat e Qendrës Botërore të Tregtisë. Në qoftë se duam të jemi pjesëmarrës në planin madhështor të Perëndisë për grumbullimin botëror të myslimanëve në mbretërinë e Tij, së pari ne duhet të "shkundim" injorancën dhe apatinë tonë për t'u marrë me botën myslimane.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që të krishterët përreth botës do t'i kenë parasysht këto pengesa dhe do të ndërmarin hapat për t'i kthyer ato në ura, në mënyrë që t'u japin mundësinë myslimanëve të njohin Krishtin.*

Namumba e Ganës

Abdallahu është njëri nga rreth 100,000 njerëzit e tjerë të popullit të tij, të cilët njihen si namumba. Ai banon së bashku me familjen e tij në kryeqytetin tradicional, Bimbilla, që ndodhet në cepin juglindor të rajonit verior të Ganës. Si një namumbas i vërtetë që është, Abdallahu u rrit si një mysliman, megjithatë, animizmi luan një rol domethënës dhe të njëjtë në jetën e tij të përditshme.

Kur u pyet se çfarë e shtyu të bëhej i krishterë, ai tregon buzagaz: "...për shkak se kam parë dritën. E kam parë herë pas here për shumë vite atë dritë të pastër që nuk përshkruhet dot me fjalë; ndryshonte shumë nga dritat e tjera që kishin lidhje me shtrigërinë apo me frymërat e këqija. Një natë e pashë në ëndërr këtë dritë, e cila po ndriçonte mbi vajzën time. Pa kaluar shumë kohë, një pastor nga një fis i afërt më erdhi në shtëpi dhe e ftoi vajzën time të arsimohej në shkollën ku punonte gruaja e tij. Për shkak të asaj ëndre që kisha parë, unë pranova. Unë madje e pyesja vajzën se çfarë kishte mësuar ajo gjatë kohës në shkollë."

Në atë kohë isha shumë i sëmurë.

Një ditë drejtoresha e shkollës ndjeu se duhej të lutej për të afërmit e sëmurë të nxënësve. Atë mëngjes, ndësa isha i shtrirë në dyshek, papritmas pashë atë dritë dhe menjëherë u shërova. Kur vajza më tregoi rreth lutjes, e kuptova se prej nga më kishte ardhur shërimi. Fillova që të ndiqja takimet në kishë së bashku me vajzën. Pastori kaloi kohë me mua duke më shpjeguar ungjillin dhe pas pak javësh unë me vajzën time i besuam Jezusit si Zoti dhe Shpëtimtari ynë."

Në këtë cep të largët të rajonit të Afrikës Perëndimore, drita e Jezusit po shkëlqen si një qiri në mes të errësirës.

SI MUND TË LUTEMI?

- *Lutuni që Perëndia do të përgatisë shumë namumbas të tjerë për t'u takuar me besimtarë të Jezusit.*
- *Lutuni që ata pak të krishterë në Bimbilla (kryesisht punëtorë nga fiset e tjera, të cilët punojnë aty), të jenë të zellshëm për t'u takuar me namumbasit dhe t'u flasin atyre për Jezusin.*
- *Lutuni për besimtarët e rinj, të tillë si Abdallahu, që të rriten në besimin e tyre dhe të jenë dëshmitarë të guximshëm të Jezusit.*



Hapa praktikë

Perëndia po punon sot në botën myslimane dhe Fryma e Tij po thërret me mijëra myslimanë në një jetë të re me Jezu Krishtin. Por si mund të jemi ne bashkëpunëtorë në atë që po bën Perëndia? Ja 5 hapa që mund të bëjmë që tani:

(1) Lutuni për myslimanët

Kur një besimtare me origjinë myslimane dhe banuese në Afrikën Veriore u pyet se pse shumë veta nga populli i saj po shihnin ëndrra dhe vizione të Krishtit, përgjigjja e saj ishte: “Unë besoj se lutjet e shumë njerëzve në mbarë botën janë ngritur në qiell, ku janë bërë si re të mëdha dhe sot këto “re” lutjesh po lëshojnë mrekulli hiri dhe shpëtimi mbi popullin tim.”

(2) Mbështetni shërbesat dhe projektet ungjillëzuese për myslimanët

Myslimanët nuk kthehen te Krishti thjesht për shkak të një ëndrre apo vizioni. Siç është shkruar: “... Dhe si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? ...” (Romakëve 10:14). Kjo është detyra jonë: t’ua transmetojmë ungjillin myslimanëve. Sot ka shumë shërbesa të efektshme për myslimanët, por ato kërkojnë mbështetjen

tonë me lutje të shpeshta. Ne duhet të japim kontributin tonë për një arritje sa më të efektshme të myslimanëve.

(3) Shkoni tek myslimanët

“...Dhe si do të dëgjojnë, pa predikues?” (Romakëve 10:14). Ndoshta disa nga ju që po lexoni këtë material, Perëndia ju ka shtënë fort në zemër të çoni ungjillin te myslimanët, për të cilin ata akoma nuk kanë dëgjuar. Në qoftë se nuk “shkundim” prej nesh frikën dhe urrejtjen, injorancën dhe apatinë, ne kemi për të qenë vetëm spektatorë në historinë shpenguese të Perëndisë, që po shpaloset sot mes myslimanëve.

(4) Shërbejuni myslimanëve në komunitetin tënd

Ka shumë myslimanë, të cilët janë larguar nëpër kombe të tjera ose për shkak të arratisjes së tyre nga terrori i Shtëpisë së Islamit, ose thjesht për shkak se po kërkonin një shpresë më të mirë për fëmijët e tyre. Me çfarë syri do t’i shohësh myslimanët emigrantë në kombin tënd? Me paragjykime dhe duke i shmangur apo si një mundësi e pashoqe që të është dhënë, për të ndarë me ta dashurinë dhe hirin e Jezu Krishtit?

(5) Ndani ungjillin me myslimanët

Falë punës pioniere të misionarëve, jeta e të cilëve ka qenë një kontribut për lëvizjet e shumta drejt Krishtit që po shohim sot, na janë hapur shumë rrugë për t’u komunikuar myslimanëve dashurinë dhe ungjillin e Jezu Krishtit në mënyrë të efektshme. Kur e bëjmë këtë, ne sinkronizohemi me flladin e Frymës së Shenjtë që po fryn në Shtëpinë e Islamit dhe menjëherë kuptojmë se jemi përfshirë në të njëjtin qëllim me Të.

SI MUND TË LUTEMI?


- *Lutuni për myslimanët në komunitetin tuaj dhe nëpër botë, kurdoherë që lexoni apo dëgjoni rreth tyre.*
- *Lutuni për misionarët dhe besimtarët me prejardhje myslimane, të cilët po e shpjen ungjillin më thellë në Shtëpinë e Islamit.*
- *Lutuni që Perëndia do të ngrejë akoma më shumë dëshmitarë për myslimanët dhe kërkojini Atij t’ju tregojë se çfarë mund të bëni për t’u shërbyer myslimanëve dhe për të ndarë besimin tuaj me ata kudo ku ndodheni: në shtëpi dhe rreth e përqark botës.*

Lutja përgjatë vitit

Kalendari mysliman bazohet në ciklet hënore, me zanafillën e tij që në datën 16 korrik 622, kur Muhamedi emigroi nga Meka për në Medinë (ky emigrim njihet si hixhra). Ja disa data të tjera në vitin 2015, që janë të rëndësishme për myslimanët dhe ditë në të cilat mund të luteni për ta.

Date	Event
18 qershor – 17 korrik	Ramazani (muaji i agjërimit)
14 korrik	<i>Lailat ul-Qadr</i> (Nata e Kadrit ose Nata e fuqisë)
17 korrik	<i>Id-al-Fitr</i> (Thyerja e agjërimit)
21–26 shtator	<i>Hajj</i> (Haxhi – Pelegrinazhi në Mekë)
22 shtator	<i>Arafa</i>
23 shtator	<i>Id-al-Adha/Qurbani</i> (Festivali i Kurbanit)
14 tetor	<i>Hijra</i> — Dita e vitit të ri
23 tetor	<i>Ashura</i> (Shiitët — 10 ditë për të përkujtuar vdekjen e Hysenit në Qerbela/ Sunitët - e festojnë këtë ditë si dita në të cilën Perëndia krijoi.





Po tani? Si do të vazhdosh të lutesh?

Meqë je lutur përgjatë gjithë kohës së Ramazanit, kujtohu që të mbash botën myslimane në lutje përgjatë gjithë pjesës tjetër të vitit.

Si do të doje ta shihje Perëndinë të lëvizte gjatë vitit që vjen në jetën e një myslimani të cilin e njeh? Po në komunitetin për të cilin je lutur?

Shkruaje këtu më poshtë:

"30 ditët", Shqipëri
Kufia Postare 119,
AEP 33, Tiranë
ywamalbania@gmail.com
<http://www.ywamalbania.com/>

<http://pray30days.org/>

© Copyright 2015

